



RIINVEST
INSTITUTI PËR HULLIMTË ZHVILLIMORE
INSTITUTE FOR DEVELOPMENT RESEARCH

FORUMI EKONOMIK VJETOR

Tejkalimi i kurthit të rritjes së pamjaftueshme dhe rritja e efikasitetit të investimeve

NËNTOR, 2024



FORUMI EKONOMIK VJETOR

**TEJKALIMI I KURTHIT
TË RRITJES SË
PAMJAFTUESHME DHE
RRITJA E EFIKASITETIT
TË INVESTIMEVE**

PËRGATITUR NGA:

Alban Hashani – udhëheqës i projektit
Muhamet Mustafa – koordinator i projektit
Alma Bajramaj
Benet Maloku
Gent Beqiri
Halim Mahmuti
Liridon Kryeziu
Petrit Gashi
Tringë Shkodra
Valentin Toçi
Visar Vokri

MBËSHËTETUR NGA:



BOTUAR NGA:

INSTITUTI RIINVEST
Lidhja e Prizrenit nr. 56 Prishtinë 10000,
Republika e Kosovës
Tel: + 381 (0)38 244320;
www.riinvestinstitute.org

Këndvështrimet e shprehura në këtë raport janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të mbështetësve. Instituti Riinvest merr përsipër përgjegjësinë e plotë për përmbajtjen e këtij raporti.

E drejta autoriale © 2024 nga INSTITUTI RIINVEST. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem reproduktimi, apo të transmetohet, në asnjë formë apo nga asnjë mjet, qoftë elektronik, apo mekanik, fotokopjues, regjistruar apo tjetër, pa e cituar burimin.

Përmbajtja

SHKURTESAT	6
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE DHE REKOMANDIME	7
HYRJE	9
PJESA I	11
1. RITJJA EKONOMIKE DHE KONFIGURACIONI MAKROEKONOMIK	11
1.1 Konteksti global dhe rajonal.....	12
1.2 Rikthimi në trendin e rritjes para COVID-19	13
1.3 Rritja e “kurthuar” ekonomike në Kosovë	14
1.4 Sektori i jashtëm	19
1.5 Sektori financiar	27
1.6 Shpenzimet qeveritare – Buxheti	28
1.6.1 Të ardhurat dhe shpenzimet buxhetore.....	28
1.6.2 Të ardhurat buxhetore	30
1.6.3 Struktura e shpenzimeve buxhetore	32
1.6.4 Analiza e borxhit shtetëror	37
PJESA II	39
2 MJEDISI BIZNESOR	39
2.1 Barrierat kryesore në mjedisin biznesor 2024.....	40
2.2 Rregullativa ligjore dhe fiskale	42
2.3 Qasja në financa	42
2.4 Ekonomia informale dhe korrupsioni	43
2.5 Tregu i punës.....	43
2.6 Barrierat administrative dhe infrastruktura	44
2.7 Barrierat e brendshme	44
PJESA III	45
3. Investimet	45
3.1 Vëllimi, dinamika dhe struktura e investimeve	46
3.2 Efikasiteti i investimeve dhe rritja ekonomike	52
3.3 Mjedisi Investues	58
3.3.1 Mjedisi institucional dhe politik	58
3.3.2 Qasja në financa	60
3.3.3 Shërbimet mbështetëse të bizneseve dhe asistenca teknike.....	62
Referencat	64

Shkurtesat

ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
BB	Banka Botërore
BE	Bashkimi Evropian
BERZH	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
BP	Ballkanit Perëndimor
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
CEFTA	Central European Free Trade Agreement
ERA	Hapësirën Evropiane e Kërkimeve
FEV	Forumi Ekonomik Vjetor
FKGK	Fondin Kosovar për Garanci të Kredive
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
GFCF	Bruto Kapitalit Fiks
HMIC	Higher-Middle-Income Countries
ICOR	Incremental Capital Output Ratio
IJD	Investimet e jashtme direkte
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës
KFOS	Fondacionit Kosovar për Shoqëri të Hapur
MINT	Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
NPQ	Ndërmarrjet Publike Qendrore
NVM	Ndërmarrje të Vogla dhe të Mesme
OECD	Organisation for Economic Co-operation and Development
OSHP	Bordit të Organit Shqyrtues të Prokurimit
PVB	Produkti Vendor Bruto
TIK	Teknologjia e Informimit dhe Komunikimit
TVSH	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar
WEF	Forumi Ekonomik Botëror
wiiw	Instituti i Vjenës për Studime Ekonomike Ndërkombëtare

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE DHE REKOMANDIME

Ky raport studimor është përgatitur për t'i shërbyer debatit në sesionin e sivjetmë të Forumit Ekonomik Vjetor 2024 të Institutit Riinvest (FEV24), një produkt i ri i Institutit që filloi me FEV23 dhe synon që edhe në vazhdim të vlerësojë zhvillimet ekonomike në ndërrim të viteve.

Megjithëse ka një ngecje në krahasim me planifikimet e Qeverisë sa i përket normës së rritjes së Produktit Vendor Bruto (PVB), Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) dhe Banka Botërore (BB) i shohin lëvizjet ekonomike në Kosovë në një dritë më pozitive se vitin e kaluar, veçanërisht në aspektin e stabilitetit makroekonomik dhe performancës buxhetore. Në fakt, rritja ekonomike është kthyer në trendin para pandemisë COVID-19, duke osciluar rreth 4 përqind. Parashikimet e Qeverisë, që shoqërojnë Buxhetin për vitin 2025, presin një rritje ekonomike të PVB-së prej 5.6 përqind, një projeksion dukshëm më i lartë se ai i FMN-së, BB-së dhe Institutit të Vjenës për Studime Ekonomike Ndërkombëtare (wiiw), të cilët parashohin një rritje rreth 4 përqind. Ky parashikim mund të sfidohet nga vështirësitë për rritjen e pritur në terma realë të eksporteve (7 përqind), e kjo vlen edhe për pritjet për rritjen e investimeve, posaçërisht atyre publike. Brengosës është edhe përkeqësimi i gjendjes në sektorin e jashtëm, ku kemi një zvogëlim të mbulueshmërisë së importit me eksport të mallrave dhe një rritje të deficitit në bilancin tregtar, llogarinë rrjedhëse, atë financiare dhe përgjithësisht në bilancin e pagesave. Niveli i remitencave pothuajse mbetet në nivelin e vitit të kaluar, ndërsaq investimet e jashtme kanë shënuar një trend rritës edhe këtë vit (me rreth 7 përqind) në një situatë kur tërheqja e investimeve në sektorin e industrisë përpunuese dhe produkteve me vlerë të lartë të shtuar ende është shumë e ulët. Sektori financiar vazhdon me performancë të mirë, me rritje të kredive (rreth 12) dhe nivel të ulët të kredive të këqija, por jo ende sa duhet i përshtatur për të mbështetur projektet zhvillimore me kushte më të volitshme.

Buxheti i parashikuar për vitin 2025 vazhdon trendin e rritjes së viteve të fundit, por trashëgon probleme të theksuara lidhur me strukturën në realizimin e investimeve kapitale si dhe financimin e ulët të arsimit, kërkimeve shkencore dhe shëndetësisë. Në të gjithë këta sektorë të ndjeshëm dhe esencialë për të rritur cilësinë e zhvillimit, Kosova mbetet shumë prapa vendeve të rajonit dhe kërkesave të Bashkimit Evropian (BE).

Sipas vlerësimeve të udhëheqësve të bizneseve në kuadër të hulumtimit të realizuar me afro 500 ndërmarrje të vogla dhe të mesme (NVM) private (shtator-tetor 2024), barrierat kryesore në afarizmin e tyre janë informaliteti dhe evazi- oni fiskal, dhe migrimi i punëtorëve, të dyja pothuajse me të njëjtin intensitet, të pasuara me aftësitë dhe arsimimin e punëtorëve, korrupsionin dhe koston e financimit, me një intensitet prej 60-64 pikë nga 100 maksimale.

Vëmendje e posaçme në këtë raport i kushtohet vëllimit, strukturës dhe efikasitetit të investimeve të shprehur në rritjen e PVB-së. Përderisa Kosova investon vitet e fundit 31-33 përqind të PVB-së, që është një intensitet më i lartë i investimeve në rajon, kjo nuk shprehet në mënyrë adekuate në rritjen ekonomike për shkak të efikasitetit më të ulët, matur me raportin inkremental të kapitalit dhe outputit (ICOR), përkatësisht normës me të cilën kapitali i investuar ndikon në rritjen e PVB-së. Kosova veçohet me një ICOR të lartë prej 4.62 për dallim nga vendet e tjera të rajonit, ku ky tregues lëviz nga 2.21 (Serbi) deri në 3.91 (Maqedoni të Veriut). Kjo do të thotë se Kosovës për të arritur një normë të rritjes i duhet të përdorë më tepër kapital se vendet e tjera. Shkaqet janë në produktivitetin ende të ulët, nivelin e shfrytëzimit të kapaciteteve prej rreth (i cili rezulton të jetë rreth 60 përqind), strukturën sektoriale të pavolitshme të investimeve si dhe strukturën poashtu të pavolitshme teknike, ku dominojnë investimet në objekte ndërtimore dhe tokë në dëm të pajisjeve, kërkimeve e zhvillimit dhe inovacioneve.

Në modelin ekzistues të rritjes ekonomike në Kosovë, rritja e konsumit ndikon në rritje të importit të mallrave të konsumit dhe kjo ul normën e rritjes ekonomike. Kjo krijon një qark të papërshtatshëm të funksionimit të ekonomisë që nuk i shërben mirë dinamikës së rritjes. Në vijim të theksimit të nevojës për një model të ri të rritjes ekonomike në raportin për sesionin e vjetëm të FEV23, duhet përsëritur patjetër se ky stad i zhvillimit të vendit kërkon një angazhim serioz dhe ngritje të cilësisë së qeverisjes makroekonomike për të dalë nga i ashtuquajti 'kurthi i të ardhurave mesatare'. Raporti i sivjetmë i BB-së lidhur me këtë problem, që karakterizon situatën edhe të një numri vendesh të tjera, sugjeron një sintezë rekomandimesh për një rrugëtim të përqendruar të këtyre vendeve nëpër të ashtuquajturat "3I-të": Investime, Infuzion, Inovacion.

Një nga problemet kyçe me të cilat përballlet Kosova për ta tejkaluar këtë gjendje është një e metë pothuajse kronike: strukturave qeverisëse të Kosovës u ka munguar ambicia për ndryshime cilësore të realitetit ekonomik në Kosovë. Pra, nevojitet një ambicie zhvillimore e liruar nga inercioni dhe rutina e politikave të deritashme dhe një përqendrim i energjive, konsensus nacional për një zhvillim që vendin e shpie kah ekonomitë e zhvilluara. Kosova nuk mund të dalë nga ky kurth pa i rritur së pari investimet në sektorët me potencial eksportues, dhe së dyti pa investuar shumë më tepër në dije e teknologji të reja, hulumtime, zhvillim dhe inovacione. Këto përbëjnë elementet qenësore për një model të ri të rritjes ekonomike. Kjo do të rezultonte me rritje të eksporteve dhe rritje të ofertës vendore konkurruese të produkteve dhe shërbimeve.

Bazuar në të gjeturat e këtij Raporti rekomandohet sa vijon:

1. Qeveria e Kosovës të krijojë një trup kompetent të përbërë nga ekspertë vendorë dhe ndërkombëtarë për të përvijuar një dokument afatgjatë me vizion, ambicie dhe zgjedhje politikash e masash me të cilën tejkalohe në mënyrë efektive modeli i deritashëm i rritjes ekonomike dhe tejkalohe problemet e barrierat karakteristike për 'kurthin e ekonomive me të ardhura mesatare' që e pengojnë për të hyrë në shoqërinë e vendeve me të ardhura të larta brenda një periudhe të arsyeshme.
2. Nevojitet një ristrukturim i shpenzimeve nga buxheti i Kosovës në dobi të rritjes së dukshme të shpenzimeve dhe investimeve për arsim e edukim, shëndetësi dhe kërkime zhvillimore e inovacione, ashtu që brenda një

periudhe 2-3 vjeçare të arrihet mesatarja e vendeve të rajonit dhe gradualisht edhe mesatarja e investimeve dhe shpenzimeve qeveritare në këta sektorë në raport me PVB-në si në BE.

3. Qeveria duhet të analizojë thellësisht dobësitë kronike në realizimin e investimeve kapitale, sidomos investimeve nga klauzola e investimeve të mbështetura nga huatë e jashtme, dhe të rrisë përgjegjësinë e lidërshiptit në ministri, agjenci dhe organizata të tjera buxhetore për të tejkaluar problemet e theksuara aktuale.
4. I tërë sektori i jashtëm gjithashtu duhet t'i nënshtrohet një rishikimi të detajuar kritik për të zvogëluar deficitet, sidomos në këmbim të mallrave, duke promovuar një sistem integral masash për nxitjen dhe lehtësimin e eksportit.
5. Asociacionet e biznesit duhet të angazhohen me anëtarësinë e tyre për të rritur vetëdijen se edhe investimet private - pra nga vetë bizneset - për kërkime, zhvillim dhe inovacione, duhet të jenë në agjendën e përditshme të tyre.
6. Asociacionet e biznesit gjithashtu duhet të punojnë në bashkëpunim me organizatat hulumtuese dhe institucionet përkatëse për avancimin e procesit investues në Kosovë, në kuptim të investimeve më efektive në pajisje, dije dhe teknologji të reja, në vend të investimeve të tejdimensionuara në objekte ndërtimore dhe tokë e infrastrukturë tjetër, një pjesë të cilave duhet të mbulohet me investimet kapitale nga buxheti publik.
7. Institucionet kërkimore dhe akademike duhet të krijojnë bashkëpunim sistematik me sektorin privat, dhe për këtë duhet të avancohet edhe kadri ligjor dhe ai nënligjor, sidomos në universitetet publike.
8. Rekomandohet përmirësimi i sistemit të grumbullimit dhe analizës së informacionit statistikor, me fokus të veçantë në investimet e sektorit privat, për të siguruar të dhëna më të sakta dhe të detajuara që mund të mbështesin vendimmarrjen strategjike dhe planifikimin efektiv të politikave ekonomike.

HYRJE

Ky raport studimor është përgatitur për t'i shërbyer debatit në sesionin e sivjetmë të Forumit Ekonomik Vjetor 2024 (FEV24), i cili pason sesionin e vitit të kaluar nismëtar të Forumit dhe që synohet të vazhdojë të jetë tradicional.

Forumi Ekonomik është inicuar për të siguruar një debat të angazhuar dhe produktiv lidhur me ecuritë ekonomike, problemet prezente gjatë vitit kalendarik dhe pritjet për vitin e ri. Duke siguruar një audiencë të përbërë nga aktorët më përgjegjës dhe më të interesuar për zhvillimet ekonomike, me pjesëmarrës të zgjedhur nga institucionet publike, asociacionet e biznesit, udhëheqës ekzekutivë të bizneseve, ekspertë nga institucionet financiare dhe qarqet kërkimore e akademike, FEV i Institutit Riinvest synon të brendohet si një ngjarje e shënuar dhe me vizibilitet të lartë për zhvillimet ekonomike në vend.


Në përgatitje të FEV24, Instituti Riinvest ka hartuar një raport studimor i cili përfshin:

- a) problemet prezente lidhur me dinamikën dhe cilësinë e rritjes ekonomike, pritjet për të ardhmen, sidomos për vitin vijues, dhe politikat ekonomike. Raporti jep përgjigje se pse rritja ekonomike në Kosovë është në një lloj kurthi dhe si mund të tejkalohet kjo situatë sipas studimeve teorike dhe empirike si dhe përvojës së vendeve të tjera;
- b) evolucionin e mjedisit biznesor dhe intensitetin e barrierave të caktuara në mjedisin e biznesit;
- c) një analizë të detajuar të investimeve në Kosovë, si temë speciale për FEV24, përfshirë vëllimin, strukturën dhe efikasitetin e tyre, duke dhënë rekomandime dhe sugjerime për politikat ekonomike në fushën e nxirrjes së investimeve dhe rritjes së efikasitetit të tyre.

Ky raport është përgatitur duke analizuar studimet e Institutit Riinvest, Programin Qeveritar dhe reflektimet e tij në Buxhetin për vitin 2024, realizimin e tij dhe draftin e Buxhetit për vitin 2025, raportet për konsumin buxhetor, kumtesat e Agjencisë së Statistikave të Kosovës lidhur me ecuritë në sektorë të ndryshëm gjatë vitit 2023, raportet mujore dhe vjetore të BQK-së, raportet e fundit të FMN-së, BB-së, BER-ZH-it, BE-së si dhe prognozatat e wiiw-it. Veç kësaj, është zhvilluar një anketë me afro 500 biznese (gjatë periudhës shtator–tetor 2024), me përqendrim në aktivitetet investive në sektorin privat. Ky studim është zhvilluar në bazë të një mostre të rastësishme standarde të nxjerrë në bazë të regjistrit të ATK-së të bizneseve aktive. Për pjesën e raportit mbi investimet, jemi bazuar edhe në pasqyrat financiare të paraqitura nga bizneset në ATK dhe kemi konsultuar publikimet e BQK-së për Investimet e Jashtme Direkte dhe rezistencat.

Raporti është mbështetur nga granti i Fondacionit Kosovar për Shoqërinë e Hapur (KFOS) dhe lidhet gjithashtu me aktivitetet e “Forumit 2015,” i cili që nga viti i kaluar zhvillon aktivitetet si një program dhe platformë debatesh për integrimin euro-atlantik të Kosovës në kuadër të Institutit Riinvest. Falënderojmë KFOS-in për mbështetjen e këtij projekti të rëndësishëm. Konstatimet e prezantuara përfaqësojnë pikëpamjet e ekipit kërkimor, përkatësisht të Institutit Riinvest dhe jo domosdoshmërisht të aktorëve të tjerë të përfshirë në realizimin e këtij projekti.

**RRITJA EKONOMIKE
DHE KONFIGURACIONI
MAKROEKONOMIK**



1.1 Konteksti global dhe rajonal

Projeksionet më të reja të FMN-së lidhur me rritjen ekonomike globale në vitet 2024 dhe 2025 mbesin pak a shumë në suaza të rritjes së arritur në vitin 2023 (3.3 përqind), dhe atë me një përqindje prej 3.2 për vitin 2024 dhe 3.3 në vitin 2025.¹ Megjithatë, një tendencë ngushtimi të divergjencave sa i përket nivelit të PVB-së në rrafshin global, nën ndikim të rritjes më dinamike në ekonomitë emergjente (Kina, India, etj.), rreziku nga inflacioni ende mbetet potencial. Kjo sidomos ka të bëjë me ato vende ku çmimet e shërbimeve po ngadalësojnë trendin e deflacionit dhe me këtë po ndikojnë ende tek normat e larta të interesit. Kjo ndodhë përkundër faktit se rënia e çmimeve të energjisë dhe ushqimit e ka sjellë normën e inflacionit thuaja në nivelin e para pandemisë. E gjithë kjo situatë shoqërohet me tensionet dhe pasiguritë politike dhe tregtare të ndikuara nga situata e paqartë gjeopolitike. Konfiguracioni i projeksioneve të FMN-së jep shenjë për një rritje më të vogël në ekonomitë më të rëndësishme evropiane gjatë vitit 2024 dhe 2023, si në Gjermani (0.2 / 1.3), në Francë (0.9/1.3), në Itali (0.7/0.9), dhe përgjithësisht për hapësirën evropiane (0.9/1.5). Përderisa rritja ekonomike në Kinë po fluktuon ndërmjet 3-5 përqind, India po merr primatin midis ekonomive emergjente me rritje 6-7 përqind.

Për të kompletuar këtë perspektivë mund të shërbehemi me vlerësimin pak a shumë të ngjashëm të udhëheqësve ekzekutiv të kompanive më njohura globale të shprehur në 'McKinsey Global Survey' lidhur me kushtet aktuale dhe të pritura që mund ta influencojnë rrjedhën e biznesit të tyre. Së pari ata i vlerësojnë kushtet e tashme me një kujdes të shtuar në krahasim me muajt e përparshëm. Lëvizjet i karakterizojnë më tepër si stabilizuese se sa përmirësuese. Ata konsiderojnë se risku kryesor vjen nga mos stabiliteti gjeopolitik si dhe fakti se këtë vit dhe në vitin e ardhshëm më tepër se gjysma e popullsisë globale do të votojnë për zgjedhjet vendore. Menjëherë pas këtyre vjen frika nga ringritja e inflacionit për këto arsye.²

Në raportin e BB-së lidhur me trendet dhe parashikimet në Euro-Azinë Qendrore parashikimet lidhur me rritjen ekonomike për vitet 2024 dhe 2025 për Ballkanin Perëndimor janë vlerësuar 3.3 përqind dhe 3.5 përqind respektivisht.³ Përafërsisht në këto relacione sillen edhe projeksionet për rritjen ekonomike të Turqisë, një partner ky i rëndësishëm ekonomik i rajonit. Ndonëse niveli i inflacionit ka rënë, çmimet kanë mbetur rreth 20 përqind më të larta në krahasim me periudhën para COVID 19 dhe kjo është edhe më e shprehur tek produktet ushqimore ku ky nivel arrin 50 përqind. Krahas këtyre pritjeve, BB tërheq vërejtjen për "kokëdhembje" që vijnë nga disa drejtime si: rritje më e ultë tek partnerët kryesorë tregtar në hapësirën evropiane, politikat monetare restriktive, rritjen e ngarkesës me borxhe dhe eskalimin e tensioneve gjeopolitike rajonale dhe globale. Të gjithë këta faktorë mund të ndikojnë në frenimin e rritjes ekonomike dhe në 'erozionin e konfidencës së investitorëve dhe konsumatorëve'. Megjithatë, projeksionet reflektojnë pritjet për një trend më të gjallë të rritjes ekonomike në rajon për shkak të lëvizjeve në tregun e punës, përmirësimit të pagave dhe investimeve të nxitura nga fondet e BE-së. Sipas BB-së, hapësira për përmirësim megjithatë mbetet mjaft e gjerë për tërë rajonin, sidomos në fushën e një dinamizmi më të madh të bizneseve (hyrja dhe dalja e bizneseve në treg), mjedisi konkurrues nuk është nxitës për inovacione dhe krijim e absorbim të dijeve dhe teknologjive të reja. Kjo vështirësohet me involvimin e tepërt të shtetit në ekonomi dhe dobësitë serioze në arsim dhe edukim. E tërë kjo reflektohet me ngecje në përmirësimin e nivelit të produktivitetit të punës. Një nga brengat e BB-së ndërlidhet me pasojat që mund të paraqiten nga vazhdimi i emigrimit të popullatës së re të edukuar, karakteristikë kjo për gjithë vendet e rajonit. Zgjidhja këtu shihet me përfitimet nga rrjetëzimi me diasporën, maksimizimi i përfitimeve nga remitencat dhe zgjerimi i mundësive dhe shanseve në tregun vendor të punës. Plani i ri për rritjen ekonomike për Ballkanin Perëndimor pritet të nxisë poashtu rritjen ekonomike në rajon në kombinim me thellimin e reformave të nevojshme strukturore dhe demokratike.

1 FMN: World Economic Outlook, Korrik 2024

2 Strategjia dhe Praktika e Financave Korporative, Parashikimi i Kushteve Ekonomike. McKinsey & Company, Shtator 2024

3 BB: Përditësimi ekonomik për Evropën dhe Azinë Qendrore, Pranverë 2024

● **Tabela 1.** Parashikimet e rritjes ekonomike në Ballkanin Perëndimor (BB dhe wiiw)

	BB		wiiw	
	2024	2025	2024	2025
Shqipëria	3.3	3.4	4.0	3.8
Bosnja e Hercegovina	2.8	3.2	2.6	2.9
Kosova	3.8	3.9	4.1	3.8
Mali i Zi	3.4	3.5	3.5	3.7
Maqedonia e Veriut	2.5	2.9	1.8	2.3
Serbia	3.8	4.2	3.7	3.7
Ballkani Perëndimor	3.2	3.5	3.4	3.4

Burimi: BB: Ruajtja e momentumit të rritjes, Tetor 2024;

wiiw: Dobësitë e jashtme zbutin rritjen e fuqishme të drejtuar nga konsumatori, Tetor 2024.

1.2 Rikthimi në trendin e rritjes para COVID-19

Pas një rritjeje më të ngadalësuar në vitin 2023, ekonomia e Kosovës këtë vit dhe vitin e ardhshëm pritet të rikthehet në ritmet e rritjes para COVID-19, me një normë prej rreth 4 përqind. Megjithëse ka një ngecje në krahasim me planifikimet e Qeverisë,⁴ FMN dhe BB i shohin lëvizjet e rritjes ekonomike në Kosovë në një dritë më pozitive se vitin e kaluar veçmas në aspektin e stabilitetit makroekonomik dhe performancës buxhetore. Në këtë mënyrë Kosova renditet ndër vendet me norma rritjeje ekonomike afër 4 përqind për këto dy vite, e shoqëruar afër nga Shqipëria dhe Serbia. Pasi lavdëron përparimin në vjeljen e taksave dhe menaxhimin e risqeve financiare, FMN e konsideron të rëndësishme që të krijohen mekanizma për të siguruar një nivel adekuat të rezervës buxhetore dhe sidomos nevojën për të forcuar menaxhimin e investimeve publike. Ky përmirësim në krahasim me vitin 2023 reflektohet edhe në rritjen e te ardhurave buxhetore për rreth 12 përqind, si dhe vlerësimet preliminare për rritjen e PVB-së për 5.4 përqind në tremujorin e parë dhe 4.3 përqind në tremujorin e dytë. Presioni i inflacionit ka rënë, çmimet vazhduan të rriten me një intensitet më të ultë kështu që inflacioni ishte 2.2 përqind në krahasim me gushtin e vitit të kaluar. Megjithatë rritja e deficitit në bilancin

tregtar mbetet një problem serioz. Rritja e importeve e nxitur të shumtën nga rritja e konsumit është më dinamike se rritja e eksportit. Kjo është ndikuar nga rritja e te ardhurave, rritja e kredive (12 përqind) dhe një përmirësim i shpenzimeve publike në krahasim me vitin paraprak.

Gjykuar sipas perceptimeve të udhëheqësve të kompanive private në Kosovë lidhur me lëvizjet e biznesit të tyre, viti 2023 ishte më i mirë se viti 2024 ngase 28 përqind e kompanive raportojnë rritje të shitjeve (55 përqind pa ndryshime dhe 13 përqind rënie). Në vitin 2024 vetëm afër një e treta e kompanive kanë pasur rritje, ndërkaq kjo përqindje pritet të 54 përqind kur është fjala për pritjet në vitin 2025.⁵ Shikuar nga kjo perspektivë, rritja e parashikuar e PVB-së me dokumentet e buxhetit për 2025, sipas normës 5,6 përqind, mund të sfidohet me vështirësitë për rritjen në terma real të eksporteve (7 përqind) dhe rritjen e investimeve private (6.1 përqind). Gjithashtu, gjykuar trendët e viteve të fundit realizimi i afro 800 milion euro investime të parashikuara kapitale duket i mbivlerësuar. Duhet pasur parasysh vështirësitë eventuale për konsolidimin e institucioneve qeveritare pas zgjedhjeve nacionale me 9 shkurt që mund të ndikojnë në pritjet e bizneseve dhe familjeve dhe gjithashtu në ciklin biznesor duke e sfiduar poashtu normën e parashikuar të rritjes ekonomike.

4 Në projeksionet e Buxhetit të vitit 2024 ka qene planifikuar një rritje ekonomike prej 4.6 përqind.

5 Anketa e Institutit Riinvest, tetor 2024.

● **Tabela 2.** Rritja reale e PVB të Kosovës në % dhe projeksionet per 2024 dhe 2025

	2019	2020	2021	2022	2023	2024f	2025f
BERZH			10.7	4.3	3.3	4.0	4.0
IMF	4.8	-5.3	10.7	4.3	3.3	3.8	4.0
BB	4.8	-5.3	10.7	4.3	3.3	3.8	3.9
wiiw		-5.3	10.7	4.3	4.1	4.1	3.8
Qeveria e Kosovës (Projektligji për Buxhetin e vitit 2025)	4.8	-5.3	10.7	4.3	4.1	4.5	5.6

Burimi: Autorët në bazë të të dhënave nga BERZH; FMN; BB; wiiw; Qeveria e Kosovës

Për të kompletuar këtë pasqyrim duhet shtuar dy probleme kronike, sidomos përkeqësimin e bilancit tregtar (mbuluueshmeria e importit me eksport të mallrave ka rënë nga rreth 17.9 përqind në vitin 2022 në rreth 15 përqind në vitet 2023 dhe 2024), dhe problemin serioz të ndërlidhur me nivelin e ultë të pjesëmarrjes në tregun e punës. Sipas vlerësimeve të BB-së vetëm 37 përqind e popullsisë në moshë pune është e punësuar.⁶ Kjo do të thotë se nga 100 banorë në moshë pune (15-64 vjet) vetëm 37 prej tyre janë të punësuar. Ky fakt e zbehtë ndryshimin pozitiv në statistikat zyrtare për rënien e papunësisë në rreth 10 përqind. Duket se shumë nga ata në moshë pune janë të dekurajuar për të hyrë në tregun e punës nëpërmjet regjistrimit në zyra të punësimit edhe për shkak të mungesës së instrumenteve e politikave aktive të tregut të punës, si dhe për shkak rolit të kufizuar të zyrave të punësimit për ndërmjetësim në punësim. E tërë kjo shprehet në reduktim të normës statistikore te papunësisë. Kur kësaj i shtojmë edhe trendin brengosës të migrimit sidomos të të rinjve të papunësuar del se rrjedhimisht kjo i ka bërë te komplikua matjet dhe vlerësimet statistikore për lëvizjet në tregun e punës.

1.3 Rritja e “kurthuar” ekonomike në Kosovë

Siç e kemi theksuar edhe në Raportin studimor “Një model i ri për rritjen e qëndrueshme ekonomike” të përgatitur për Forumin Ekonomik Vjetor 2023,⁷ rritja ekonomike në Kosovë, që thuaja dy dekada sillet 3-4 përqind. Kur merret parasysh konteksti historik i karakterizuar me tranzicionin e gjatë e të vështirë dhe specifik me pasoja të rënda të luftës, dezindustrializimit brutal dhe pozitën koloniale në vitet 90, ky nivel i rritjes ekonomike është i pamjaftueshëm. Ky realitet specifik historik krijoi një hendek të madh në kuptim të prangëljes në krahasim me vendet e tjera në rajon dhe më gjerë sidomos me BE-në. Ndërlidhur me këtë, rritja ekonomike këto dy dekada e gjysmë është ndërtuar mbi një situatë kritike emergjente dhe si e tillë nuk krijoi parakushtet për të tejkaluar shpërpjesëtimet makro ekonomike sidomos papunësinë dhe deficitin tregtar. Ky model, i bazuar kryesisht në faktorë të jashtëm si remitencat, asistencat e huaj teknike dhe financiare, si dhe kreditë, thuajse ka humbur fuqinë e tij transformuese dhe potencialin për të gjeneruar rritjen e nevojshme për Kosovën. Si rezultat, ky model nuk po arrin të kontribuojë në rritjen e konvergencës

6 BB: Raporti i rregullt ekonomik i Ballkanit Nr.26, vjeshtë 2024.

7 Instituti Riinvest : Një Model i Ri për Rritje të Qëndrueshme Ekonomike, nëntor 2023

me vendet e BE-së (BE27) dhe në tejkalimin e shpërpjesëtimeve në konfigurimin makroekonomik të vendit.

Modeli ekzistues i rritjes ekonomike në Kosovë thuhet se ka 25 vite që bazohet kryesisht në rritjen e konsumit. Kjo është karakteristike edhe për vitet e fundit ku konsumi është kontribuesi kryesor i rritjes ekonomike. Në dy vitet e fundit, norma e rritjes ekonomike prej 3.3 dhe 3.8 përqind ka qenë kryesisht e nxitur nga konsumi, i cili ka kontribuar me 3.9 dhe 4.6 pikë përqindje përkatësisht. Nga ana tjetër, investimet kanë pasur një kontribut më modest, duke shtuar 1 dhe 1.7 pikë përqindje në këto norma të rritjes (Tabela 3). Nën supozimin se importi dhe eksporti në Kosovë do ishte i barabartë (pra eksporti neto do të ishte baraz me zero), atëherë rritja ekonomike do të ishte $3.9 + 1 = 4.9$ përqind në vitin 2023 dhe në vitin 2024 rreth 6,3 përqind ($4.6+1.7$). Mirëpo bilanci negativ tregtar ndikon në uljen e normës së rritjes ekonomike. Kjo do të thotë se për ta servuar këtë konsum është përdorur një sasi e produkteve dhe shërbimeve të importuara, të prodhuara jashtë vendit, andaj kjo bën që rritja ekonomike të zvogëlohet nga 4,9 në 3,3 përqind ($4.9 - 1.7$) dhe në 3,8 përqind në vitin 2024 ($6.3 - 2.5$). Kjo do të thotë se Kosova ka të pamjaftueshëm kontributin e investimeve dhe eksporteve për të gjeneruar një rritje më të madhe ekonomike. Në këtë model rritja e konsumit ndikon në rritje të importit të mallrave të konsumit dhe kjo ulë normën e rritjes ekonomike, duke krijuar një qark të papërshtatshëm të funksionimit të ekonomisë. Pjesëmarrja e komponentës importuese në konsum zvogëlon ndikimin e multiplikatorit në përshejtimin e rritjes ekonomike, të themi figurativisht nga "shpejtësia e 5" në shpejtësinë "2" ose "3" për pjesën e importuar të konsumit. U ndalem me këtë elaborim të thjeshtë, për të demonstruar domosdoshmerinë e ndryshimeve rrënjësore në politikat zhvillimore qeveritare e që ndërliken me mënyrën se si duhet adresuar ngërçin dhe kurthimin me politikat që kanë favorizuar një model të tejkaluar të rritjes ekonomike.

● **Tabela 3.** Kontribuuesit e rritjes ekonomike në Kosovë 2023 dhe 2024

Përshkrimi	2023	2024
Rritja reale ekonomike %	3.3	3.8
Kontributi në rritje		
Konsumi	3.9	4.6
Investimet	1.0	1.7
Eksporti neto (Eksporti -Importi)	-1.6	-2.5

Prezantuar sipas të dhënave nga BB: Raporti i rregullt ekonomik i Ballkanit Nr.26, vjeshtë 2024.

Vështirësitë prezente lidhur me këtë në Kosovë nuk janë aq unike, ngase ka diku 108 vende me nivel mesatar të të ardhurave, (sipas klasifikimit të Bankës Botërore)⁸ që përpëlitën me trendin e pavolitshëm të rritjes ekonomike, dhe duke qenë të kurthuruara nuk mund të kalojnë tek klubi i ekonomive të zhvilluara. Ky fenomen i njohur si "Kurthi i vendeve me të ardhura mesatare" është bërë aktual e problematik ngase ai mund të konservojë një gjendje të pakënaqshme zhvillimi për një kohë të gjatë.

Pikërisht për këtë arsye mesazhi ynë kryesor në Forumin Ekonomik Vjetor (FEV23), vitin e kaluar, për politikëbërësit dhe akterët ekonomik duke përfshirë edhe bizneset ishte të promovojnë dhe zbatojnë një model të ri të rritjes ekonomike, i cili përqendrohet në politika efektive të rritjes së ofertës konkurruese të produkteve dhe shërbimeve vendore për eksport dhe tregun vendor. E kjo mund të arrihet me investime në teknologji të reja, dije të reja, investime në kërkime e zhvillim dhe inovacione, pra edukim dhe shëndetësi. Të gjithë këta faktorë janë përcaktues për rritjen e kapacitetit absorbues të ekonomisë dhe shoqërisë për një rritje më domethënëse e cilësore të ekonomisë.

8 Sipas raportit të Bankës Botërore: World Development Report Concept Note: Middle Income Countries (2024), klasifikimi i Bankës Botërore, bazuar në kalkulimet sipas metodës "World Bank Atlas", aktualisht ka 26 vende me të ardhura të ulta kombëtare bruto (LIC), ku të ardhurat kombëtare bruto (GNI) janë deri në \$1,135 për banor. Pas këtyre vijnë 64 vende me të ardhura mesatare të ulta (LMIC), me të ardhura kombëtare bruto për banorë ndërmjet \$1,136 dhe \$4,465. Më pas janë 54 vende me të ardhura të larta mesatare (HMI), ku të ardhurat bruto kombëtare për banorë janë ndërmjet \$4,466 dhe \$13,845. Kosova, me të ardhura kombëtare për banorë prej \$5,590 (2022), bie në këtë kategori. Këtu përfshihen gjithashtu edhe 5 vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor. Në fund janë 83 vende me të ardhura të larta (HIC), ku të ardhurat kombëtare bruto janë mbi \$13,846 për banor.

Në shtator të këtij viti, Banka Botërore publikoi një raport të veçantë të titulluar “Middle Income Trap” / “Kurthi i të Ardhurave Mesatare”, duke trajtuar problemin e rritjes ekonomike në këto vende nga shumë aspekte. Si një sintezë reko-mandimesh, raporti sugjeron një rrugëtim të këtyre vendeve nëpër të ashtuquajturat “3I”: Investime, Infuzion, Inovacion.

“I” e parë ka të bëjë me rritjen e investimeve në kapitalin fizik (makineri, pajisje dhe infrastrukturë), si dhe zgjerimin e investimeve në përmirësimin e kapitalit njerëzor – edukimi, trajnimi dhe shëndetësia cilësore. Politikat ekonomike dhe investive duhet të krijojnë dhe zbatojnë strategji që nxisin tërheqjen e investimeve private dhe publike, veçanërisht investimeve të huaja, të cilat sjellin një “infuzion” të ideve, modeleve dhe teknologjive të reja në ekonominë vendase. Ky raport, veçanërisht në kapitullin 3, analizon këtë çështje në detaje.

“I” e dytë ndërlidhet me infuzionin, ku vendet përqendrohen në imitim, përvetësimin dhe shpërndarjen e teknologjive të reja dhe modeleve biznesore, të cilat janë karakteristike për ekonomitë e zhvilluara. Kjo nënkupton aftësimin e industrive vendore që të bëhen furnizues të produkteve dhe shërbimeve në planin global. Thelbësore për këtë fazë janë reformat e suksesshme strukturore që mbështesin qëndrueshmërinë e arritjeve dhe ndryshimeve pozitive në mjedisin konkurrues të jashtëm. Në këtë aspekt, Kosova ende ndodhet në një stad fillestar.

“I” e tretë ndërlidhet me inovacionin, ku kapacitetet vendore zhvillohen dhe kontribuojnë në shtimin e vlerës edhe për teknologjitë globale, duke u bërë “krijues të dijes globale”. Kjo është karakteristikë për vendet me të ardhura të larta mesatare dhe paraqet një sfidë të madhe për mbështetjen e qëndrueshmërisë së firmave ekzistuese në tregun global. Në këtë fazë kërkohet maturitet dhe kapacitet i avancuar i institucioneve për të zvogëluar risqet për bizneset e suksesshme dhe inovative nëpërmjet skemave stimuluese, si dhe për të nxitur investimet në kërkim dhe zhvillim.

Eksperienat tregojnë se kalimi në këtë fazë kërkon përkushtim ndaj ambicieve më të larta zhvillimore dhe reforma efektive. Kjo kërkon angazhime serioze nga politikkbërësit për të ndërlidhur me sukses strukturën makroekonomike

të rritjes me përcaktuesit e saj në nivel mikroekonomik, si nxitjet, politikat, organizatat dhe fuqizuesit e procesit të rritjes ekonomike. Në këtë kontekst, Kosova duhet të fillojë të merret shumë më seriozisht me këto çështje.

Duke qenë se Kosova tani më ka hyrë në grupin e “vendeve me të ardhura të larta mesatare” (HMIC) ajo duhet të adresojë njëkohësisht të tri “I”. Dhe kjo natyrisht shtrihet te adresat tepër serioze për qeverisjen makroekonomike në nivel vendi si dhe për bizneset vendore që të avancojnë aftësinë e tyre konkurruese.

Investimet, si një faktor thelbësor i dinamikës, strukturës dhe cilësisë së rritjes ekonomike, si dhe i zhvillimit ekonomik në përgjithësi, analizohen në mënyrë të detajuar në kapitullin e tretë të këtij raporti. Ky kapitull përfshin një vlerësim të bazuar në hulumtime në terren me sektorin privat, si dhe një analizë të investimeve publike dhe atyre të jashtme, duke u mbështetur në të dhëna zyrtare të publikuara.

Ballafaqimi i Kosovës me këtë problem mund të marrë si rrethanë pozitive “Planin Ekonomik të Rritjes për BP” nga BE, i cili mund të ndihmojë që të mbështete fazën një “i” dhe fazën e dy “ii” për një rritje të investimeve. Për këtë reforma strukturore mbetet kritike sidomos në zhvillimin e sektorit të energjisë, sigurimin e ujit, avancimit të kapitalit human dhe agjendën e konektivitetit me korridoret e trafikut fizik e digjital rajonal dhe paneuropian. Kjo duhet të arrihet njëkohësisht me zotimet dhe obligimet ndërlidhur me Agjendën e Gjelbër dhe përcaktimin e saj për “0 Emission neto” të CO₂ dhe dekarbonizimin.

Është e ditur se integrimi evropian është një nga modelet e suksesshme që i ka ndihmuar vendet që të ballafaqohen me sukses me “kurthin e vendeve me të ardhurave mesatare”, model ky i njohur si “makina e konvergencës evropiane.”⁹ Hulumtimet e viteve të fundit kanë sugjeruar se bashkëpunimi rajonal ka vetëm një rol lehtësues dhe ndihmues, por nuk ka fuqi transformuese për ekonomitë e BP-së pa integrimin në BE.¹⁰ Që nga viti 1990 e deri tash vetëm 34 vende me të ardhura mesatare kanë arritur të kalojnë në grupin e vendeve me të ardhura të larta. Prej tyre më shumë se një e treta janë vende që këtë e kanë arritur në procesin e integritimit në BE. Të tjerat janë vendet e Azisë Juglindore si Tajvani

9 World Bank: Balkans Regular Economic Report, Retaining Growth Momentum NO.26 Fall 2024

10 M. Mustafa & A. Hashani: Bashkëpunimi ekonomik rajonal, mundësitë për Shqipërinë dhe Kosovën ASHAK, 2024

dhe Korea Jugore të cilat i kanë përqendruar politikat e tyre zhvillimore në produkte dhe shërbime me vlerë të lartë të shtuar për eksport si dhe kanë rritur investimet në edukim, në teknologji të reja dhe inovacione për të ngushtuar hendekun me teknologjitë e avancuara botërore.¹¹

Në përgjithësi, qeveritë në Kosovë i kanë kushtuar pak vëmendje këtyre çështjeve vitale zhvillimore. Në mënyrë kronike u ka munguar ambicia për ndryshime cilësore të realitetit ekonomik në Kosovë. Në përgjithësi Kosovës i nevojitet një vizion i ri zhvillimor. Nevojitet një ambicie zhvillimore e liruar nga inercioni dhe rutina e politikave të deritashme, të karakterizuara kryesisht me konfrontime antagoniste midis akterëve politik, thuaja për secilën çështje. Është i domosdoshëm një përqendrim i energjive për një zhvillim që vendin e shpie kah ekonominë e zhvilluara.

Pra Kosova nuk mund të del nga ky kurth pa i rritur së pari investimet në sektorët me potenciale eksportuese dhe së dyti në dije e teknologji të reja, hulumtime, zhvillim dhe inovacione. Kjo do të rezultonte me rritje të eksporteve dhe rritje të ofertës vendore konkurruese të produkteve dhe shërbimeve.

Gjatë viteve të fundit kemi pasur një rritje edhe të eksporteve e sidomos të eksportit të shërbimeve, megjithatë kontributi i kësaj në cilësinë e rritjes ekonomike mbetet i kufizuar edhe për se faktin se vlera e shtuar e produkteve dhe shërbimeve që eksportohen nuk duket të jetë e madhe.

Një problem tjetër i modelit ekzistues është se përbërësit e PVB (GDP) në aspektin e sektorëve dhe veprimtarive nuk kanë pësuar ndryshime të domosdoshme cilësore. Nga tabela 4 shohim se pesha e kontributit të industrisë përpunuese, minierave, bujqësisë, aktiviteteve profesionale dhe kërkimeve shkencore dhe e edukimit e arsimit në vlerën e rikrijuar ka rënë në vitin 2023 në krahasim me 2010. Kjo ka ndodhur në llogari të rritjes së peshës së tregtisë, transportit, hotelarisë dhe ndërtimtarisë. Një zhvillim i tillë nuk shkon në favor të rritjes së eksportit dhe lehtësimit të kalimit nga "I " e parë tek "nga "I" e parë te "I" e dytë dhe më pas te "I" e tretë, rrugëtim që duhet ta bëjnë vendet me ardhura mesatare drejt ekonomive të zhvilluara. Andaj, krahas ndryshimeve lidhur me vëllimin dhe strukturës teknike së investimeve (patundshmëri, objekte, pajisje) duhet bërë ndryshime në politikat sektoriale investuese.

11 Sipas WB: World Development Report Concept Note

● **Tabela 4.** Struktura e PVB sipas veprimtarive

Pjesëmarrja e aktiviteteve ekonomike ndaj BPV-së si përqindje nga 2010 në 2023

Përshkrimi i aktiviteteve ekonomike	2010	2015	2019	2023
Bujqësia, pylltaria dhe peshkimi	9.5	7.7	7.2	7.8
Industria nxjerrëse	2.5	2	2	1.7
Industria përpunuese	13.8	13.3	12.9	12.8
(Furnizimi me energji elektrike dhe gaz) + Furnizimi me ujë	3.1	4.1	4	3.7
Furnizimi me energji elektrike dhe gaz	2.5	3.4	3.4	3.1
Furnizimi me ujë	0.7	0.7	0.7	0.6
Ndërtimtaria	7.7	7.6	8.2	8.2
Tregtia me shumicë dhe pakicë; riparimi i automjeteve dhe motoçikletave	13	12.3	12.8	14.2
Transporti dhe magazinimi	4	4.6	4.4	4.5
Hotelet dhe restorantet	1.1	1.6	2.1	2.1
(Informimi dhe komunikimi) + (Aktivitetet financiare dhe të sigurimit)	5.4	5.6	5.7	6.3
Informimi dhe komunikimi	1.5	1.8	1.9	2
Aktivitetet financiare dhe të sigurimit	3.8	3.8	3.9	4.3
(Afarizmi me pasuri të patundshme) + (Aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike) + (Aktivitetet administrative dhe mbështetëse) + (Administrimi publik dhe i mbrojtjes; sigurimi I detyrueshëm social)	16.1	15.6	15	13
Afarizmi me pasuri të patundshme	8.8	7.5	7	5.9
Aktivitetet profesional, shkencore dhe teknike	1.5	1.6	1.4	1.4
Aktivitetet administrative dhe mbështetëse	0.7	0.7	0.7	0.7
Administrimi publik dhe i mbrojtjes; sigurimi i detyrueshëm social	5.1	5.9	5.9	5
Edukimi	3.6	4.1	3.7	3.2
Shëndetësia dhe aktivitetet e punës sociale	1.8	2.1	2.2	2.2
(Art, zbavitje dhe rekreacion + Shërbime tjera)	0.9	0.8	0.6	0.5
Art, zbavitje dhe rekreacion	0.4	0.4	0.2	0.2
Shërbime tjera	0.5	0.4	0.4	0.3
Bruto vlera e shtuar, Gjithsej	82.4	81.3	80.8	80.1
Taksat neto në produkte	17.6	18.7	19.2	19.9
GJITHSEJ PVB (me çmime aktuale)	100	100	100	100

Burimi: ASK, 2024

Ajo që është veçanërisht brengosëse ka të bëjë me investimet në fushat e kërkimeve shkencore dhe zhvillim, arsim dhe edukim, inovacione, dhe në shëndetësi. Sektori i kërkimeve dhe inovacioneve ende përballet me një kornizë ligjore ja mjaft të ndërtuar dhe ende jo mjaft e opercionalizuar për zbatim. Struktura institucionale ende nuk është e kompletuar për të zbatuar në mënyrë efektive politikat dhe programet kërkimeve dhe inovacioneve. Programi Kombëtar i kërkimeve shkencore 2023 -2028 ka mbetur i paoperacionalizuar dhe i pazbatuar dy vitet e fundit. Në MASHTI ende nuk janë krijuar institucionet, si Agjencia/ Fondi për Kërkime, që do të duhej të zbatonin këtë program. Megjithatë, një kthesë pozitive paraqet drafti i Ligjit për Inovacione dhe Ndërmarrësi, i cili parashikon edhe krijimin e Fondit për Inovacione. Megjithatë, ky dokument ka mbetur pa u aprovuar, duke qëndruar në fazën e një drafti që daton nga dhjetori i vitit 2023.¹² Kosova ende ka një pjesëmarrje modeste në Hapësirën Evropiane të Kërkimeve (ERA) duke përfshirë edhe programin më të madh të kërkimeve Horizon Europe. Gjithashtu, Kosova ende nuk është bërë pjesë e Bordit të Arritshmerisë për Inovacione të BE (EU Innovation Score Board), andaj mungon sistemi i infomacionit statistikor për zhvillim të inovacioneve si dhe për disa komponentë të tjera të rëndësishme të prodhimit kërkimor dhe shkencor. Tabela 5 dëshmon për financimin tepër të ultë (bazuar në përqindjen e PVB) për kërkime, inovacione, arsim dhe shëndetësi, komponentëve kyçe këto për formimin e kapitalit human që do ndikonte në rritjen e kapaciteteve absorbuese për dinamizmin e zhvillimit dhe promovimin e zbatimin e modelit të ri te rritjes ekonomike në Kosovë.

● **Tabela 5.** Investimet ne K&I, Arsime dhe Shëndetësi viti 2023 si % e PVB

	Kosova	Ballkani Perëndimor	BE
Kërkimet dhe inovacionet	0.1 - 0,2 ¹³	0.50	1.7
Arsimi dhe edukimi	3.5	4.6	4.7
Shëndetësia (përfshirë shpenzimet nga xhepi të qytetarëve)	5.8	8.5	10.2

1.4 Sektori i jashtëm

Performanca e tregtisë së jashtme të Kosovës në vitet e fundit tregon një prirje të vazhdueshme drejt varësisë nga importet dhe kjo krijon vështirësi për përmirësimin e bilancit tregtar. Bilanci i këmbimit të shërbimeve ka pasur ndikim pozitiv, por ai i mallrave, që është thelbësor për dinamikën tregtare, ka ndikuar në rritjen e deficitit.

Të dhënat për periudhën janar-shtator 2024 tregojnë një përkeqësim të deficitit tregtar në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2023 (Tabela 6). Gjatë kësaj periudhe, eksportet u rritën nga 2.2 në 2.5 miliardë euro. Në anën tjetër, ky përmirësim mbetet i pamjaftueshëm për të kompensuar rritjen më të madhe të importeve, të cilat arritën afër 5.4 miliardë euro. Aktualisht, eksportet e mallrave dhe shërbimeve së bashku mbulojnë 46 përqind të importeve, duke shfaqur një përmirësim të lehtë nga periudha e një viti më parë. Megjithatë, kjo përqindje mbetet larg nga ajo që do të nevojitej për një bilanc më të ekuilibruar.

12 Sipas Agjendës së reformave të Kosovës në kuadër të instrumentit të BE-së për reforma dhe rritje ekonomike në Ballkanin Perëndimor, miratimi i ligjit për inovacion dhe ndërmarrësi parashihet që të bëhet në dhjetor të vitit 2024. (linku: <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2024/10/IRRRe-Agjenda-e-Reformave-te-Kosoves.pdf>)

13 Nuk ka të dhëna zyrtare statistikore për Kosovën për shpenzimet e K&I. Vlerësimet e Institutit Riinvest bazuar në Anketën dhe Buxhetin e Kosovës.

● **Tabela 6.** Eksporti dhe importi i shërbimeve ndër vite (në miliona euro)

Viti	Eksport	Import	Bilanci tregtar	Mbulueshmëria e eksportit me import (%)
2019	2,068	3,982	-1,914	52
2020	1,470	3,651	-2,181	40
2021	2,659	5,191	-2,532	51
2022	3,435	6,346	-2,911	54
2023	3,837	6,806	-2,969	56
Janar - Shtator 2023	2,222	4,943	-2,723	45
Janar - Shtator 2024	2,471	5,418	-2,947	46

Burimi: ASK

Duke përjashtuar vitin 2023, kur pësuan një rënie prej rreth shtatë përqind në krahasim me vitin 2022, eksportet e mallrave në Kosovë patën një trend rritës (Figura 1). Sidoqoftë, kjo u shoqërua edhe me rritje të importeve kështu që deficitin në bilancin tregtar vijoi duke u thelluar, ku në vitin 2023 arriti vlerën rekorde-rreth 4.6 miliardë euro. Thënë ndryshe, për çdo një euro të eksportuar në 2023, Kosova ka importuar

rreth 6.3 euro, apo 0.7 euro më shumë se në vitin paraprak. Ndërkaq, deri në muajin shtator të këtij viti eksportet dhe importet e mallrave u rriten respektivisht me 8 dhe 9 përqind krahasuar me periudhën e njëjtte të vitit 2023. Në këtë periudhë, vlera e eksporteve të mallrave ka arritur në 690 milionë euro kurse ajo e importeve në 4.6 miliardë euro.

● **Tabela 7.** Eksporti dhe importi i mallrave (në miliona euro)

Viti	Eksport	Import	Bilanci tregtar	Mbulueshmëria e eksportit me import %
2019	393	3233	-2840	12.2
2020	475	3048	-2573	15.6
2021	753	4320	-3567	17.4
2022	932	5219	-4287	17.9
2023	871	5469	-4598	15.9
Janar - Shtator 2023	643	4249	-3606	15.1
Janar - Shtator 2024	690	4554	-3864	15.2


Burimi: ASK dhe BQK

Sipas strukturës sektoriale, vërejmë se mallrat të cilat Kosova i eksporton më së shumti në 2024 përsëri janë metalet bazë dhe artikuj prej tyre, me rreth 25 përqind të totalit të vlerës së eksporteve. Megjithatë, pas një mbylljeje 20-mujore për shkak të çmimeve të larta të energjisë elektrike, prodhimi i nikelit rifilloi në qershor 2023, por prodhuesi abstenoj nga eksportet e menjëhershme për shkak të çmimeve të pafavorshme të eksportit (FMN, 2024). Kategoria tjetër me radhë janë plastika, goma dhe artikuj prej tyre, kurse vendin e tretë e mbajnë artikujt të ndryshëm të prodhuar (mobilieritë, krevatet, dyshekët, mbajtëset e dyshekëve, jastëqet dhe shtresa të ngjashme të mbushura), me 7 pikë përqindje më pak se perioda e njejtë e vitit të kaluar.

Vlen të ceket se eksportet e dyshekut ranë përgjysmë në vitin 2023, kryesisht për shkak se Fabrika e Dyshekëve në Gjakovë ka ndërprerë prodhimin dhe e ka zhvendosur në Maqedoninë e Veriut, një lëvizje që mund të jetë ndikuar nga masat e reja antidumping të vendosura në tregun amerikan. Këto masa, të cilat pretendojnë se Kosova ka përfituar nga subvencione të qeverisë, kanë çuar në vendosjen e tarifave që kanë bërë eksportet më pak konkurrues. Një rrethanë pozitive është edhe rritja e diverifikimit të produkteve dhe mallrave që eksportohen prej 32 produkteve në vitin 2015 në mbi 110 produkte në vitin 2023 dhe 2024 (Figura 1)¹⁴

14 Grafikon nga Endrit Pllashniku, Kosovo Data. Burimi: Dogana e Kosovës.

● **Figura 1.** Numri i produkteve që tejkalon një milion euro në vlerën vjetore të eksportit (2015-2023, Janar – Shtator 2024)



Për më tepër, nëse analizojmë të dhënat e nëntë muajve të parë të vitit 2024, vërejmë se Shtetet e Bashkuara, që në vitin 2023 ishin ndër vendet kryesore ku Kosova eksportonte më shumë, kanë rënë në renditje, duke u pozicionuar në vendin e gjashtë. Sa i përket eksporteve në vendet e BE-së, deri tani kanë arritur vlerën në 199.8 milionë euro, ose rreth 32 përqind e eksporteve të përgjithshme. Ndërsa rreth gjysmën e mallrave të gjithmbarshme Kosova e eksporton në vendet e CEFTA-s.

Ngjashëm me vitin e kaluar, mallrat që u importuan në vlerë më të madhe deri në muajin gusht të 2024 vazhdojnë të jenë produktet minerale (lëndët djegëse minerale, vajrat minerale dhe produktet për distilimit të tyre; substancat bituminoze) me 14 përqind, më pas vijnë ushqime të përgjithshme, pije, pije alkoolike dhe duhan me 13 përqind dhe me rreth 12 përqind të vlerës totale të importit janë makineritë, pajisjet mekanike dhe elektrike. Pa dallim prej vitit që lamë pas, vendet nga të cilat janë importuar këto produkte kryesisht janë Turqia, Gjermania dhe Kina. Importet e Kosovës nga vendet e BE-së deri tani kanë arritur shifrën 1.9 miliardë euro, ose 46 përqind e importeve të përgjithshme. Megjithatë, kur analizohen importet nga vendet e CEFTA-s, vërehet një rënie e theksuar në importet nga Serbia, ku prej periudhës janar-gusht 2022, importet kanë shënuar një rënie prej 71.9 përqind. Kjo ndodhi pas sulmit terrorist në Banjaska në shtator të vitit të kaluar, me vendim të Qeverisë së Kosovës, për të ndaluar importet e mallrave me origjinë nga Serbia për shkaqe sigurie, me përjashtim të materialeve ndërtimore. Ky vendim ngriti shqetësime, veçanërisht në kontekstin e promovimit të tregut të përbashkët evropian në kuadër të procesit të Berlinit dhe rolin e Kosovës në CEFTA. Si rezultat, ky restriksion i importit nga Serbia u hoq në këmbim të skanimit të mallrave të importuara me pajisje të avansuara dhe të vendosjes së pozitës adekuate të Kosovës në CEFTA .

Sipas parashikimeve të wiiw-it (2024), nga viti 2024 deri në vitin 2026, pritet një rritje graduale si në eksporte ashtu edhe në importe. Pavarësisht rritjes së lehtë vjetore të eksporteve, deficitit tregtar pritet të zgjerohet gjatë këtyre viteve, duke arritur në -4,950 milionë euro deri në vitin 2026. Gjithashtu, projeksionet e Fondit Monetar Ndërkombëtar për ekonominë e Kosovës sugjerojnë se eksportet pritet të rriten, duke kontribuar pozitivisht në rritjen e PBV-së me 2.0 përqind në 2024, 1.3 përqind në 2025 dhe 2.3 përqind në 2026, mirëpo që kjo do të peshohet nga niveli më i lartë i importeve.

Seriozitetin e kësaj e tregon edhe prezantimi i Politikës Industriale në fillim të vitit të kaluar. Ndër objektivat në këtë dokument, objektivi i dytë pikërisht synon uljen e deficitit tregtar përmes dy rrugëve kryesore: rritjes së eksporteve të mallrave të prodhuara në Kosovë dhe zëvendësimi i importeve me prodhime vendore. Për të arritur këtë, theksohet nevoja për përmirësimin e financimit për prodhuesit e orientuar drejt eksportit, zgjerimin e qasjes në tregjet e reja përmes diversifikimit të produkteve dhe përmirësimin e strategjive të eksportit. Po ashtu, zëvendësimi i produkteve të importuara me prodhime vendore kërkon stimulimin e prodhimit dhe promovimin e tyre përmes prokurimit publik dhe politikave që mbështesin konkurrencën e drejtë për produktet vendase.

Sa i përket shërbimeve, çdo vit e më tepër shohim një rritje të konsiderueshme të eksporteve (Tabela 8). Madje, tregtia në shërbime gjatë vitit 2023 u karakterizua me rritje të bilanci pozitiv, që arriti vlerën prej 1.6 miliardë euro apo 16.9 përqind e PVB -së (BQK, 2024). Eksportet totale të shërbimeve deri në korrik të 2024 kanë arritur në rreth 1.8 miliardë euro, që paraqet një rritje prej 13 përqind nga periudha e njëjtë e vitit të kaluar e deri në fund të vitit parashihet të arrijë afër vlerës tre miliardë.

● **Tabela 8.** Eksporti dhe importi i shërbimeve ndër vite (në miliona euro)


Viti	Eksporti i shërbimeve	Importi i shërbimeve
2019	1,675	749
2020	995	603
2021	1,906	871
2022	2,503	1,127
2023	2,966	1,337
2023 Janar - Shtator	1,579	694
2024 Janar - Shtator	1,781	864

Burimi: BQK

Si kontribues kryesor në këtë vlerë është kategoria e shërbimeve të udhëtimit, e cila përbën tre të katërtat e totalit të eksporteve të shërbimeve. Shpenzimet nga diaspora në Kosovë janë shtytësi kryesor i kësaj dinamike, megjithatë; ka pasur gjithashtu një rritje prej 14 përqind të numrit të pasagjerëve dhe një rritje prej 7 përqind të numrit të fluturimeve gjatë vitit të kaluar (Autoriteti i Aviacionit Civil, 2023). Për më tepër, në 2023 numri i vizitorëve në Kosovë është rritur për 35 përqind krahasuar me vitin 2022, kurse numri i net qëndrimeve të vizitorëve vendor dhe të jashtëm është rritur për 86 përqind në krahasim me vitin 2022 (ASK, 2023).

Si rrjedhojë e këtyre zhvillimeve, Qeveria e Republikës së Kosovës, në bashkëpunim me akterë të tjerë, janë angazhuar për të hartuar strategjinë shtetërore të turizmit, që përfshinë periudhën 2024–2030, për të mundësuar zhvillimin e turizmit në baza konkurruese, ngritje të zhvillimit ekonomik dhe rritje të punësimit dhe më gjerë.

● **Figura 2.** Pjesëmarrja e shërbimeve në eksport dhe import (Janar - Shtator 2024)



Burimi: BQK

Pas shërbimeve të udhëtimit, kategoria e dytë me radhë janë shërbimet kompjuterike, informative dhe të telekomunikacionit, duke e vënë në pah dukshëm rritjen e sektorit të TIK-ut dhe shërbimeve dixhitale. Nga këtu, me rreth gjysmën e vlerës totale e përbëjnë shërbimet e telekomunikacionit, me 45 përqind shërbimet kompjuterike dhe në fund me vetëm tre përqind kontribuuan shërbimet e informacionit. Prej barometrit të fundit të TI-së, vërejmë se 39 përqind e këtyre kompanive fokusohen vetëm në tregjet ndërkombëtare (STIKK, 2022). Ndërsa, nga të dhënat e Administratës Tatimore të Kosovës, shohim se Kosova vitin e kaluar ka eksportuar rreth 60 milionë euro shërbime të TIK-ut në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, 44.4 milionë euro në Zvicër dhe 38.4 milionë euro në Gjermani.

Edhe te shërbimet e importuara, kategorive iu prinë shërbimet e udhëtimit, ku vlera e tyre deri në shtatë muajt e parë të 2024 është rritur për 25 përqind duke e krahasuar me 2023. Kjo kryesisht meqenëse liberalizmi i vizave ka ndodhur në janar të vitit 2024, madje, pritet që importi i shërbimeve të udhëtimit të shënojë rritje, gjë që mund të ndikojë në bilancin e shërbimeve dhe rrjedhimisht në rritjen e bilancit negativ të llogarisë rrjedhëse.

Gjatë viteve të fundit, Kosova ka parë vazhdimisht rritje në hyrjet e remitencave nga diaspora, duke reflektuar mbështetjen e vazhdueshme nga kosovarët jashtë vendit. Megjithatë, të dhënat tregojnë se ndërkohë që remitancat vijnë të rriten çdo vit, ritmi i kësaj rritjeje ka filluar të ngadalësohet. Nëse krahasojmë remitancat për periudhën janar-gusht të këtij viti (2024) me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, vërehet një rritje mjaft modeste prej më pak se një përqind.

Tabela 9. Statistikat e tregtisë se jashtme ndër vite

	Dërgesat e migrantëve		Investimet e jashtme direkte		Llogaria rrjedhëse		Bilanci nga llogaria financiare		Bilanci i pagesave	
	Në miliona euro	Si pjesë e PVB (në %)	Në miliona euro	Si pjesë e PVB (në %)	Në miliona euro	Si pjesë e PVB (në %)	Në miliona euro	Si pjesë e PVB (në %)	Në miliona euro	Si pjesë e PVB (në %)
2019	851.5	12.1	254.6	3.6	-408.3	-5.8	-161.1	-2.3	-399.5	-5.7
2020	980	14.5	345.7	5.1	-454.7	-6.7	-562.1	-8.3	-472.2	-7.0
2021	1153.4	14.5	420.7	5.3	-632.5	-7.9	-365.0	-4.6	-694.7	-8.7
2022	1222.8	13.7	732.0	8.2	-878.7	-9.9	-661.6	-7.4	-917.1	-10.3
2023	1335.8	13.8	840.1	8.7	-729.4	-7.5	-415.5	-4.3	-666.5	-6.9
2023 (Jan - Qer)	627.4	14.9	371.1	8.8	-538	-12.7	-255.7	-6.1	-491.6	-11.6
2024 (Jan - Qer)	630.1	13.9	419.1	9.3	-691.8	-15.3	-496.6	-11.0	-667.9	-14.8

Burimi: BQK dhe ASK

Edhe këtë vit dominojnë kryesisht vendet gjermano folëse (Gjermania, Zvicra) të pasuara nga SHBA-të. Remitencat vazhdojnë të kenë një ndikim të rëndësishëm në strukturën e të hyrave në ekonominë familjare në Kosovë, veçanërisht gjatë muajve të verës kur edhe rritet konsumi lokal, duke gjeneruar më shumë të ardhura për bizneset. Megjithatë, përdorimi i remitancave kryesisht për konsum nuk përmirëson aftësinë konkurruese të ekonomisë së Kosovës në afat të gjatë. Një qasje më e qëndrueshme do të ishte kanalizimi i këtyre fondeve në investime më produktive, të cilat mund të krijojnë mundësi të reja pune dhe të rrisin aftësinë prodhuese të industrisë. Përveç kësaj, mund të zhvillohen nisma që inkurajojnë diasporën të investojë drejtpërdrejt në projekte të zhvillimit lokal, duke e shndërruar remitancat në një motor më të fuqishëm të rritjes së qëndrueshme ekonomike.

Investimet e jashtme direkte (IJD) në vitin 2024 shënuan një rritje prej shtatë përqind, megjithatë struktura e tyre vazhdon të dominohet nga sektori i patundshmërive. Kjo rritje, e cila përbën një rritje prej 12 pikë përqindje në investimet në këtë sektor gjatë gjysmës së parë të vitit 2024 krahasuar me

2023, është shqetësuese pasi investimet në patundshmëri shpesh nuk kontribuojnë në mënyrë të konsiderueshme në zhvillimin ekonomik afatgjatë dhe nuk kanë një efekt multiplikativ të dukshëm. Sektorët tjerë me përqindje të konsiderueshme janë aktivitetet financiare dhe të sigurimit (16 përqind) dhe sektorin e energjisë (8 përqind). Ndërsa Zvicra udhëheq me 21 përqind të investimeve totale, e ndjekur nga Gjermania dhe Shqipëria me 19 dhe 12 përqind respektivisht, këto investime janë kryesisht në aktivitete pasive. Tërheqja e investimeve në sektorin e prodhimit, si sektori kyç i zhvillimit të potencialit eksportues, ende mbetet sfiduese.

Deficiti i llogarisë rrjedhëse si njëra nga dy komponentet kryesore të bilancit të pagesave, për vitin 2023 arriti në 738.4 milionë euro, duke përfaqësuar 7.5 përqind të PVB -së, një rënie prej 19.5 përqind krahasuar me vitin 2022. Sidoqoftë, kur krahasojmë gjashtëmujorin e parë të viteve 2023 dhe 2024, vërejmë një përkeqësim të theksuar, ku deficiti është rritur nga 538 milionë euro (12.7 përqind e PVB -së) në 692 milionë euro (15.3 përqind e PVB -së) në vitin 2024. Rritja e deficitit është ndikuar kryesisht nga përkeqësimi i bilancit të mallrave, një komponent kyç që përcakton dinamikat e

llogarisë rrjedhëse. Ky përkeqësim reflekton sfida në rritjen e qëndrueshmërisë ekonomike dhe sugjeron nevojën për masa që të nxisin eksportet dhe të reduktojnë varësinë nga importet. Në anën tjetër, llogaria financiare në gjashtëmujorin e parë të 2023 ishte -255.7 milionë euro, duke përfaqësuar -6.1 përqind të PVB -së. Ndërkohë, në të njëjtën periudhë të vitit 2024, ky bilanc ka arritur në -496.6 milionë euro, që përbën -11.0 përqind të PVB -së. Pavarësisht rritjes së investimeve të jashtme direkte në Kosovë gjatë vitit 2024, përkeqësimi i bilancit nga llogaria financiare mund të lidhet me ndikimin e investimeve portofolio dhe investimeve të tjera, të cilat kanë kontribuar në daljen neto të kapitalit.

1.5 Sektori financiar

Sektori financiar në Kosovë ka vazhduar trendet e zhvillimeve pozitive edhe këtë vit në dimensionin e stabilitetit, qëndrueshmërisë dhe rritjes. Në pikëpamje strukturore, bankat dominojnë sektorin dhe janë determinantë e ndërmjetësimit financiar. Vitin që po lëmë pas, në sektorin bankar kanë vazhduar të operojnë 11 banka, prej të cilave 8 me kapital të huaj dhe një pjesëmarrje prej 83 përqind në asetet e sektorit. Numri i degëve dhe i të punësuarve në sektor ka vazhduar trendin e rritjes, përkundër avancimeve në digjitalizim. Që nga koha e pandemisë, janë dyfishuar pagesat në e-banking dhe terminale të shitjes, si për nga numri i transaksioneve ashtu edhe për nga shuma. Për shembull, pagesat përmes këtyre kanaleve kanë shënuar një rritje vjetore prej rreth 25përqind, që tregon trende pozitive në digjitalizim. Për më tepër, Kosova prinë krahasuar me vendet e rajonit në numrin e llogarive e-banking (për një milion banorë), dhe është në mesataren e rajonit për nga numri i kartelave të debitit (për një milion banorë), duke lënë pas Bosnjën dhe Hercegovinën, Shqipërinë dhe Malin e Zi. Krahas avancimeve në digjitalizim, sektori bankar me mbështetjen e BQK-së ka shënuar progres edhe në agjendën e gjelbër, përfshirje financiare dhe financim të qëndrueshëm – e njohur si ESG, ku bankat kanë filluar edhe raportimet vjetore në këtë drejtim.

Sektori financiar mbetet mirë i kapitalizuar, profitabil dhe likuid. Treguesit e kthimit si ROA dhe ROE në sektorin bankar prej 2.6 përqind dhe 19.2 përqind respektivisht, tregojnë një kthim solid dhe të qëndrueshëm ndër vite. Likuiditeti prej rreth 31 përqind (asetet likuide në raport me detyrimet afatshkurtra), dhe raporti kredi-depozita prej 84.7 përqind,

kredi joperformuese prej vetëm 2 përqind, kapitalizim prej rreth 15.5 përqind, tregon një performancë të mirë të sektorit bankar. Edhe sektorët tjerë financiar janë karakterizuar me performancë të mirë. Për shembull, kompanitë e sigurimeve kanë përmirësuar performancën vjetore, sidomos në kapitalizim, rritje të asetëve dhe profit. Institucionet mikrofinanciare kanë vazhduar rritjen e kreditimit, kryesisht për ekonomitë familjare, duke tejkaluar shumën prej €500 milion dhe me një pjesëmarrje prej afër 10 përqind në totalin e kredive të sektorit financiar.

Kreditimi në sektorët e ekonomisë vazhdon trendet e rritjes. Kreditë kanë shënuar një rritje vjetore prej 15 përqind. Rritje më të theksuar kanë pasur kreditë për ekonomitë familjare krahasuar me firmat, 20 përqind dhe 11 përqind respektivisht. Edhe depozitat kanë shënuar rritje prej 11 përqind, që është më e ngadalshme krahasuar me vitin paraprak. Në strukturë, kreditë për ekonomitë familjare kanë rritur pjesëmarrjen për dy pikë përqindje (rreth 40 përqind). Në anën tjetër, kreditë për firmat vazhdojnë të kenë strukturë të ngjashme, e që pasqyrojnë edhe strukturën e ekonomisë. Për shembull, kreditë në sektorin e bujqësisë kanë një pjesëmarrje prej 2 përqind, industri, energji dhe ndërtim 34 përqind, dhe shërbimet 64 përqind, një trend pothuaj konsistent. Sipas maturitetit, struktura e kredive në vitet e fundit ka mbetur poashtu e njëjtë, ku kreditë me maturitet deri një vit marrin pjesë me 10 përqind, ato me maturitet 1-5 vite me 35 përqind dhe ato me maturitet mbi 5 vite me 55 përqind. Kredia në sektorin privat në raport me GDP prej afër 50 përqind është mbi mesataren e rajonit të Ballkanit Perëndimor, ku Kosova qëndron më mirë krahasuar me shumicën e vendeve.

Normat e interesit pas një periudhe të trendeve në rritje në nivelin global, të determinuara nga inflacioni dhe ecuritë e kushteve monetare globale, duket që nuk kanë reflektuar në sektorin bankar në Kosovë. Normat e interesit në kredi kanë pësuar rënie të vogël dhe rritje ato në depozita, duke zvogëluar margjinën e interesit nga 4.1 në 3.2 pikë përqindje këtë vit. Rritja e çmimeve dhe nevojat për likuiditet mund të kenë rritur nevojën për kreditim. Rrjedhimisht, presionet për rritje të normave të interesit mund të shfaqen për depozita. Në perspektivë, rritja e çmimeve mund të ndikojë në zbehjen e kërkesës duke rritur kështu nevojat për financim. Kjo më pas mund të ndikojë që kushtet e kreditimit të vështirësohen, ku prospektet e ecurive monetare (por edhe fiskale) globale japin indikacion të tillë.

Ekspozimi i sektorit financiar ndaj sektorit të jashtëm mbetet i lartë. Asetet e jashtme neto kanë arritur shumën prej €4.6 miliardë, apo afër ½ e PVB-së, ku Fondi i Kursimeve Pensionale (Trusti) merr pjesë me ½ e vlerës, e pasuar nga BQK dhe bankat komerciale. Në rritjen vjetore të aseteve të jashtme neto prej 11.5 përqind (afër €500 milion), Trusti është kontribuuesi kryesor, pasuar nga bankat komerciale dhe BQK. Në anën tjetër, kërkesat e sektorit financiar (kryesisht Trusti dhe bankat komerciale) ndaj qeverisë qendrore kanë mbetur pothuaj të pandryshuara. Performanca e mirë në tregjet ndërkombëtare të letrave me vlerë ka ndikuar në një performancë të mirë të kthimit në investime të Trustit.

Ekspozimi mjaft i lartë i sektorit financiar ndaj tregjeve ndërkombëtare të cilat po reflektojnë risqe në shumë dimensione, implikon një domosdoshmëri të fuqizohet parimi i sigurisë, i etabluar në politikat investive të institucioneve financiare (p.sh. BQK dhe Trusti). Kështu, duke subordinuar principin e kthimit në asete për një shkallë domethënëse, për një periudhë së paku afatshkurtër – për shembull, një rritje e ekspozimit të aseteve të Trustit në formën e letrave me vlerë të Qeverisë dhe depozitave në tregun financiar në Kosovë – mund të jetë e dëshirueshme. Sidoqoftë, ky pozicion i aseteve të jashtme neto, në përgjithësi, mund të jetë i ndikativ për kapacitetin absorbues të ekonomisë së Kosovës.

1.6 Shpenzimet qeveritare – Buxheti

1.6.1 Të ardhurat dhe shpenzimet buxhetore

Politika buxhetore dhe fiskale është instrumenti kryesor i Qeverisë për udhëheqjen e politikave ekonomike për të ruajtur stabilitetin fiskal dhe nxitur rritjen ekonomike. Nga analiza e të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin 2024 dhe projekcionet për vitin 2025 tregon se edhe ky buxhet është në encë në kontinuitet i instrumenteve dhe politikave nga vitet e mëparshme. Këto politika kanë rezultuar me një stabilitet makrofiskal, por edhe janë përcjellë me një strukturë të pavolitshme lidhur me shpenzimet në infrastrukturë dhe mekanizma që përshpejtojnë rritjen ekonomike, me një financim të pamjaftueshëm në arsim, në shëndetësi, kërkime shkencore e inovacione dhe një mosefikasitet kritik në realizimin e investimeve kapitale.

Për vitin 2024, të ardhurat vjetore janë vlerësuar të arrijnë në 3.02 miliardë euro, nga të cilat për periudhën (Janar – Tetor)¹⁵ janë mbledhur rreth 2.6 miliardë ose 86 përqind, ndërsa shpenzimet janë parashikuar të jenë rreth 3.3 miliardë, deri në tetor 2024 janë shpenzuar 2.3 miliardë ose 70 përqind. Me këtë ritëm të shpenzimeve dhe të hyrave, duke se deri në fund të vitit, qeveria do të mbledh të hyrat e planifikuara por nuk do të arrij të shpenzoj buxhetin e planifikuar. Për vitin 2025¹⁶ shpenzimet buxhetore pritet të rriten për 8.8 përqind krahasuar me vitin paraprak që përbëjnë 33 përqind të PVB¹⁷, ndërsa të ardhurat parashikohen të rriten për 9.2 përqind që janë rreth 30 përqind e PVB. Këto të ardhura të parashikuara do të mbulojnë rreth 92 përqind të shpenzimeve të planifikuara, duke lënë një nevojë për financim nga burime të jashtme, që do të vinë nga kreditë ndërkombëtare të FMN-së, BB dhe BE dhe burimet e brendshme nga emetimet e letrave me vlerë. Ky deficit buxhetor¹⁸ prej –2.7 përqind është pothuajse i ngjashëm me ato të vendeve të rajonit¹⁹, respektivisht, Serbia do të ketë një deficit buxhetor prej –2.2 përqind, Shqipëria –2.6 përqind, Mali Zi –3.5 përqind dhe Maqedonia e Veriut –4 përqind.

15 MFPT (2024). Seritë Fiskale Mujore: <https://mfpt.rks-gov.net/Thesari/Page/973>


16 MFPT (2024). Projektligji mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025.

17 Vlerësimi për Produkti Vendor Bruto (PVB) është marr nga Ligji për buxhetin 2025 i parashikuar nga Qeveria e Kosovës

18 Të dhënat për deficitin buxhetor janë marr nga projekt buxhetet e shteteve respektive

19

● **Figura 3.** Të ardhurat dhe shpenzimet buxhetore (miliarda euro)



Burimi: Ligji mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025

1.6.2 Të ardhurat buxhetore

Të ardhurat buxhetore vijnë kryesisht nga tre burime kryesore, tatimet indirekte, tatimet direkte dhe të hyrat jo tati-more. Afërsisht 74 përqind e të ardhurave të përgjithshme mbli-dhen nga *tatimet indirekte* (TVSH-ja, akciza dhe dogana-t). TVSH-ja është burimi kryesor i të hyrave që përbërë rreth 57 përqind të totalit. Nga të ardhurat totale të TVSH-së në 2024, dy të tretat (1 miliardë)²⁰ mbli-dhen në kufi, duke pasqyruar jo vetëm deficitin e lartë tregtar të Kosovës, por është edhe një barrë të rëndë për bizneset vendore të cilat duhet ta paguajnë tatimin ende pa filluar prodhimin ose shit-jet, p[rr]os kur [sht] [fjala p[rr] pasjisjet . Nga ana tjetër, mbled-hja e TVSH-së brenda vendit edhe pse ka një rritje nga 478²¹ milion në 534 në vitin 2025 ajo përben rreth 14 përqind e të hyrave të përgjithshme ende mbetet e pamjaftueshme. Ak-cizat (593 milion në 2024)²² mbeten burimi i dytë më i madh i të ardhurave dhe përbëjnë rreth 20 përqind e buxhetit. Këto të hyra vinë nga importi i karburanteve, cigareve dhe pijeve alkoolike.

Tatimet direkte të cilat përfshijnë tatimin mbi të ardhurat personale, tatimin e korporatave dhe tatimin mbi pronën pritet të rriten me 10 përqind në vitin 2025 krahasuar me 2024²³ dhe përbëjnë rreth 17 të totalit, kjo tregon se kemi normat tatimore relativisht të ulëta por edhe një bazë jo të mjaftueshme të mbledhjes së tatimeve brenda vendit. Për më tepër, Kosova është vendi i vetëm në rajon ku të ardhurat nga dividendët nuk taten fare dhe të ardhurat nga fitimet kapitale, veçanërisht nga transaksionet e patundshmërive, janë pothuajse të patatimuara për shkak të kufizimeve ad-ministrative (Banka Botërore, 2023). Për vitin 2025, *të ardhurat jo tatimore* pritet të arrijnë në 356 milionë euro, nga 292 milionë euro në vitin 2024, me rritjen më të madhe nga tari-fat koncesionare për shkak të rritjes së numrit të udhëtarëve në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës. Kjo strukturë e të hyrave tregon se buxheti i Kosovës kryesisht varet nga tatimet në kufi, që reflektojnë një nivelin të lartë të konsumit dhe problemin strukturor të ekonomisë.


20 Për periudhën Janar –Tetor 2024 janë mbledhur rreth 839 milion euro ose 83 përqind e të hyrave të planifikuara. MFPT (2024). Seritë Fiskale Mujore: <https://mfpt.rks-gov.net/Thesari/Page/973>

21 Për periudhën Janar –Tetor 2024 janë mbledhur rreth 382 milion euro ose 80 përqind e të hyrave të planifikuara. MFPT (2024). Seritë Fiskale Mujore: <https://mfpt.rks-gov.net/Thesari/Page/973>

22 Për periudhën Janar –Tetor 2024 janë mbledhur rreth 539 milion euro ose 85 përqind e të hyrave të planifikuara. MFPT (2024). Seritë Fiskale Mujore: <https://mfpt.rks-gov.net/Thesari/Page/973>

23 Për periudhën Janar –Tetor 2024 janë mbledhur rreth 464 milion euro ose 87 përqind e të hyrave të planifikuara. MFPT (2024). Seritë Fiskale Mujore: <https://mfpt.rks-gov.net/Thesari/Page/973>

● **Figura 4.** Struktura e të ardhurave buxhetore



Burimi: Projektligji mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025; kalkulimet e autorit

1.6.3 Struktura e shpenzimeve buxhetore


Shpenzimet e përgjithshme për vitin 2025 janë parashikuar të jene 3.6 miliardë euro, një rritje 8.8 përqind krahasuar me vitin 2024. Shpenzimet rrjedhëse për paga, subvencione dhe mallra priten të jenë 2.6 miliardë euro ose 72 përqind e shpenzimeve të përgjithshme, duke përfaqësuar 24 përqind të PVB-së. Nga këto, pagat dhe mëditje do të rriten për 14 përqind në krahasim me vitin 2024²⁴ që përfaqësojnë rreth 25 përqind të shpenzimeve. Kjo rritje vjen si pasojë e rritjes së njësisë së koeficientit të pagave në sektorin publik dhe zbatimin e rregulloreve që dalin nga Ligji për pagat publike. Subvencionet dhe transfertat janë parashikuar 1.15 miliardë euro në 2025, që përbën rreth 32 përqind të shpenzimeve të përgjithshme ose 9 përqind më shumë krahasuar me 2024²⁵, e që lidhen kryesisht me rritjen e pensioneve.

Shpenzimet për mallra dhe shërbime do të jenë 536 milionë euro dhe pjesa tjetër e shpenzimeve përfshin pagesat e interesit për borxhin publik (50 milionë euro) dhe rezervën shtetërore (10 milionë euro). Investimet kapitale për vitin 2025 do të rriten për 8 përqind nga viti paraprak dhe përbëjnë rreth 26 përqind e shpenzimeve. Një analizë e detajuar e këtyre investimeve gjendet në tabelën 10. Kjo strukturë atipike e shpenzimeve buxhetore e orientuar më shumë drejt shpenzimeve rrjedhëse sesa investimeve ngadalëson krijimin e vendeve të punës, ul produktivitetin dhe kufizon potencialin për rritje ekonomike të qëndrueshme. Struktura e buxhetet qartazi është e ngarkuar me transfere dhe subvencione në llogari të investimeve kapitale. Kjo kategori ndonëse edhe me peshë të pamjaftueshme në buxhetin e Kosovës ka probleme serioze edhe tek realizmi i investimeve të planifikuara.

24 Për periudhën Janar –Tetor 2024 janë shpenzuar rreth 706 milion euro ose 88 përqind e të hyrave të planifikuara. MFPT (2024). Seritë Fiskale Mujore: <https://mfpt.rks-gov.net/Thesari/Page/973>

25 Për periudhën Janar –Tetor 2024 janë shpenzuar rreth 808 milion euro ose 76 përqind e të hyrave të planifikuara. MFPT (2024). Seritë Fiskale Mujore: <https://mfpt.rks-gov.net/Thesari/Page/973>

● **Figura 5.** Struktura e shpenzimeve buxhetore



Burimi: MFPT (2024). Projektligji mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025

Për një periudhë katër vjeçare ose një mandat qeverisë janë planifikuar afër 3 miliardë euro investime kapitale, prej tyre janë realizuar rreth 1.78 miliardë ose 60 përqind e shpenzimeve të planifikuara²⁶. Ky mos realizim i investimeve kapitale ka ngadalësuar potencialin e rritjes ekonomike prej 1-2 përqind, ka kufizuar aktivitetin biznesor dhe ka ndikuar negativisht në përmisrësimin e shërbimeve për qytetarët. Përtej kësaj, duke konsideruar edhe rritjen e inflacionit në këto vite në mesatare rreth 20 përqind, zhvlerësimi i mjeteve të pashfrytëzuara përben edhe një tjetër problem.

Edhe pse këto investime janë rritur në komulativ nëpër vite, në 2025 përfaqësojnë rreth 25 përqind të shpenzimeve të përgjithshme ose 8 përqind të PVB-së. Në vitin 2024, ngjashëm me vitet e kaluara kemi një trend të njëjtë, ku

deri në tetor janë shpenzuar vetëm 387 milionë nga 859 milionë të buxhetuara, që përfaqëson 45 përqind të totalit. Me këtë ritëm, pritet që deri në fund të vitit të realizohen jo më shumë se 60 përqind e këtyre shpenzimeve²⁷. Ndërkohë që qeveria argumenton se mos realizimi i projekteve kapitale është penguar nga mungesa e funksionalizimit të Bordit të Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), raportet e auditimit përkatëse theksojnë se problemet kryesore janë mosnjsja në kohë e projekteve nga organizatat buxhetore, ndërprerja e kontratave për shkak të mosrealizimit të punimeve nga operatorët ekonomikë, menaxhimi jo i duhur i kontratave dhe moszgjidhja e problemeve të shpronësimit. Niveli i ulët i realizimit të projekteve kapitale në nivelin qendror ka ardhur edhe si pasojë e vonesave në përfundimin e punimeve dhe shërbimeve sipas planit të tyre dinamik (ZKA, 2023).

● **Tabela 10.** Buxhetimi dhe realizimi i investimeve kapitale (milion euro)

	2021	2022	2023	2024 (Janar - Tetor)
Buxhetimi i Investimeve kapitale	626	704	820	859
Realizimi i Investimeve kapitale	420	419	554	387
Investimet e pa realizuara	206	285	266	472
Përqindja e realizimit	67%	60%	68%	45%

Burimi: Projekt ligjet për ndarjet buxhetore: Seritë fiskale 2021 – 2024; kalkulimet e autorit

26 Shpenzimet kapitale për vitin 2024 janë llogaritur deri në muajin Tetor.

27 Llogaritjet janë bërë bazuar në trendët e shpenzimeve kapitale në tre vitet e fundit

Shpenzimet publike në nivel sektorial janë thelbësore për promovimin e stabilitetit ekonomik, rritjen e shërbimeve publike dhe sigurimin e zhvillimit të barabartë në fusha të ndryshme si arsimi, kujdesi shëndetësor, infrastruktura, mbrojtja sociale dhe siguria. Përcaktimi i fondeve zakonisht bazohet në prioritetet kombëtare, kërkesat ekonomike dhe nevojat sociale. Krahasuar me vitet e kaluar, në buxhetin e këtij viti ka ndryshuar struktura e shpenzimeve sektoriale, nga 10 sektorë prioritet sa kanë qenë deri në 2024, tani janë 16 të tillë, kjo ndoshta i ka zbërthyer me mirë destinimet buxhetore por ka humbur lidhjen me ministritë e linjës në aspektin e transparencës dhe prezantimit të të dhënave.

Ngjashëm me vitet e kaluara, kujdesi social mbetet një nga prioritetet e qeverisë e cila ka ndarë 770 milionë euro për këtë kategori ose 7 përqind e PVB-së, një shumë që është rreth tre herë më e madhe se shpenzimet për shëndetësi. Këtë vit shpenzimet e përgjithshme për shëndetësi duke shtuar edhe grandin për shëndetësi (83 milion) dhe financimin për shëndetësi rezidenciale (8 milion) janë gjithsej 370 milion euro ose 3.4 përqind e PVB.

Ky nivel i financimit të shëndetësisë është dukshëm më i ulët jo vetëm në krahasim me vendet e Bashkimit Evropian (BE) dhe atyre të OECD-së, por edhe në krahasim me vendet e rajonit, përveç Shqipërisë (rreth 3 përqind e PVB-së). Shpenzimet qeveritare për shëndetësi në Bosnje e Hercegovinë arrijnë në 6.5 përqind të PVB-së, në Mal të Zi 6.5 përqind, në Serbi 6.3 përqind dhe në Maqedoninë e Veriut 4.7 përqind.²⁸

Shpenzimet për arsim dhe shkencë për vitin 2025, duke llogaritur edhe grantin për arsim (249 milion) parashikon të jenë 388 milion ose 3.5 përqind e PVB (2025) që është nën mesataren e BE-së prej 4.7 përqind.

Ndërkohë, sektorët që lidhen me ekonominë duket se nuk janë prioritet për qeverinë në vitin 2025. Fondet për tregun e punës (33 milionë euro) dhe mbështetjen për biznese dhe industri (39 milionë euro) janë të pamjaftueshme për të adresuar nevojat emergjente dhe nuk janë në përputhje me strategjitë e Kosovës. Edhe pse Kosova ka marrë angazhime për një tranzicion të gjelbër energjetik sipas marrëveshjes së Sofjes, financimet për mjedisin (60 milionë euro) dhe energjinë (59 milionë euro) janë vetëm rreth 4 përqind e buxhetit sektorial.

28 Instituti Riinvest (2024). Një terapi e munguar për financimin e shëndetësisë. Prishtinë.

● **Tabela 11.** Korniza e shpenzimeve sektoriale në nivel qendror (milion euro)

Sektorët	2023 (Realizimi)	2024 (Buxhetuar)	2025 (Buxhetuar)	Përqindja e rritjes ose zvogëlimit (2025/2024)
Administrata Publike, Financat dhe Politika e Jashtme	234.3	371.1	350.0	-5.7%
Mbrojtja dhe Siguria	177.9	153.0	158.7	3.7%
Siguria Publike	190.5	185.1	204.2	10.3%
Drejtësia	81.0	101.4	111.8	10.2%
Mjedisi	53.9	72.9	60.7	-16.7%
Transporti dhe Komunikacioni	113.1	205.0	272.8	33.1%
Energjia	58.3	59.5	59.6	0.2%
Mbështetja Për Biznese Dhe Industri	39.9	31.3	39.7	26.8%
Bujqësia	91.1	89.8	90.3	0.5%
Kultura, Rekreacioni Dhe Sporti	56.1	99.2	107.0	7.9%
Tregu i Punës Dhe Punësimi	21.1	33.5	33.8	0.8%
Kujdesi Social	679.8	713.2	770.7	8.1%
Shëndeti	222.3	263.7	275.0	4.3%
Arsimi Dhe Shkenca	99.0	134.4	139.3	3.7%

Burimi: Projekt ligjet për ndarjet buxhetore: Seritë fiskale 2021 – 2024; kalkulimet e autorit

1.6.4 Analiza e borxhit shtetëror

Portofoljo e përgjithshme e borxhit shtetëror të Kosovës është ende në nivele të qëndrueshme dhe në kuadër të rregullave fiskale dhe ligjit për borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore i cili thekson se borxhi publik nuk duhet të kalojë më shumë se 40 përqind e PVB.


Borxhi i brendshëm kryesisht përbehet nga emetimet e bonove të thesarit, obligacionet Qeveritare dhe letrat me vlerë. Sipas parashikimeve të qeveris deri në fund të vitit 2024 kjo komponentë e borxhit publik do të arrijnë vlerën e 1.07 miliardë euro ose 53.7 përqind e borxhit të përgjithshëm. Meqenëse është pozitive që më shumë se gjysma e borxhit të përgjithshëm është i brendshëm, është brengosëse që ky borxh është duke u përdorur për të mbuluar deficitin buxhetor në destinimin e mallrave e shërbimeve dhe transfereve²⁹ e jo edhe financimin e investimeve kapitale.

Borxhi i jashtëm në fund të vitit 2024 pritet të jetë rreth 921 milion euro i cili ka shënuar rritje prej 33 përqind krahasuar me vitin paraprak. Ky borxh, është tek organizatat financiare ndërkombëtare kryesisht tek Agjencia Ndërkombëtare për Zhvillim (Banka Botërore) 36 përqind, BNRZh 13 përqind, Bashkimi Evropian 14 përqind dhe FMN me 11 përqind. Borxhi i jashtëm është huazuar me qëllim të financimit të projekteve në fushën e arsimit, bujqësisë, kadastrës, energjisë, shëndetësisë, trajtimit të ujërave të zeza, ngrohjes qendrore, rehabilitimit të rrugëve dhe hekurudhave³⁰. Gjatë vitit 2023 në Kuvend janë ratifikuar tetë (8) kredi/marrëveshje financiare, me qëllim të financimit të projekteve në sektorin e ambientit, energjisë, transportit, digjitalizimit të administratës publike si dhe reformës së financave publike dhe rritjes ekonomike. Megjithatë situata lidhur me dinamikën e zbatimit të projekteve të ndërlidhura me borxhet e kontraktuara është brengosëse. Sipas ZKA (2013) hyrja në marrëveshje të kredive dhe vonesat në tërheqjen e fondeve në dispozicion, është pasojë e planifikimit të dobët, procesit të shpronësimit dhe mungesës së kapaciteteve qeveritare për t'i shfrytëzuar në kohë dhe në mënyrë efektive fondet e huamarrjes. Si pasojë e këtyre mangësive, Qeveria në vazhdimësi është duke paguar tarifë të zotimit për këto kredi të pashfrytëzuara.

29 ZKA (2023) Raporti vjetor i Auditimit https://zka-rks.org/cms/ReportFiles/2024_24e084aa-f75c-4c23-9828-fd8dea53fe6b.pdf

30 MFPT (2023). Buletini vjetor 2023 për borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore. <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/739116D9-9225-4EEE-A131-74B48859BE49.pdf>

● **Figura 6.** Struktura e borxhit shtetëror të Kosovës



Burimi: Programi i borxhit publik 2024 – 2026 BPV, = PVB³⁰

MJEDISI BIZNESOR



Ky kapitull paraqet në mënyrë përmbledhëse sfidat e ambientit biznesor në tri vitet e fundit. Roli kritik i mjedisit biznesor në zhvillimin e sektorit privat në Kosovë ka të bëjë sidomos me barrierat që ndërlidhen më aspektin ligjor dhe fiskal, qasjen në financa, informalitetin dhe korrupsionin, tregun e punës, barrierat administrative dhe infrastrukture, dhe barrierat që ndërlidhen direkt me biznesin.

Barrierat që derivojnë nga faktorët institucional janë veçanërisht me rëndësi të analizohen me qëllim të ofrimit të rekomandimeve dhe implikimeve për politikatat që institucionet duhet t'i ndjekin. Lidhur me trendin e biznesve të hapura dhe të mbyllura ka pak ndryshime. Krahasuar më tre tremujorët e parë të vitit paraprak, në mesatare ka një rritje prej 5 përqind të bizneseve të reja të regjistruara, veçanërisht në sektorët e tregtisë, informacionit dhe komunikimit, ndërtimitarisë dhe transportit. Megjithatë, me përjashtim në tremujorin e dytë, në dy tremujorët e tjerë vërejmë që ka pasur një rënie të bizneseve të mbyllura. Gjatë tre tremujorëve të parë të 2023, janë kanë qenë 8588 biznese të reja, krahasuar me 1206 të mbyllura. Ndërsa brenda të njëjtes periudhë në vitin 2024, numri i bizneseve të reja ka qenë 9017, ndërsa ato të mbyllura 1208. Proporcioni i bizneseve të mbyllura për tre tremujorët e parë të vitit 2023 ishte për 7.5, ndërsa në 2024 ishte 7.1, që nënkupton që për çdo biznes të mbyllur në vitin 2024, 7.1 janë hapur (ASK, 2024).

2.1 Barrierat kryesore në mjedisin biznesor 2024

Në vijim janë të përmbledhura rezultatet nga anketat e rregullta të Institutit Riinvest që nga viti 2017 për një mori indikatorësh dhe pengesash me të cilat ballafaqohen bizneset në Kosovë. Tabela 12 reflekton përceptcionin e bizneseve për 30 indikatorë të ndryshëm dhe intensitetin e tyre ndër vite. Ngjyrat në tabelë reflektojnë ndikimin në të bërit biznes nga perspektiva e bizneseve për secilën barrierë, ku ngjyra e gjelbër nënkupton barrierë me intensitet të ulët, ngjyra e verdhë dhe e portokalltë nënkupton intensitet mesatar, ndërsa ajo e kuqe barrierë me intensitet të lartë.³¹ Është e qartë se këtë vit sipas vlerësimeve të udhëheqësve të bizneseve në kuadër të hulumtimit të realizuar në periudhën shtator-tetor 2024 del se pesë barrierat kryesore janë informaliteti dhe evazi- oni fiskal dhe migrimi i punëtorëve, të dyja pothuajse me të njëjtin intensitet, të pasuara me aftësitë dhe arsimimin e punëtorëve, korrupsionin dhe koston e financimit, me një intensitet prej afro 60 deri në 64 pikë nga 100 pikë maksimale.

Barrierat në mjedisin e biznesit kanë një ndikim të rëndësishëm në përcaktimin e qëndrueshmërisë dhe rritjes së bizneseve, duke ndikuar drejtpërdrejt në aftësinë konkurruese të tyre në nivel nacional dhe atë ndërkombëtar. Barrierat si qasja në financa, informaliteti i lartë, barrierat administrative, bëjnë që bizneset të ekspozohen ndaj pasigurisë ekonomike dhe rrezikut të falimentimit, duke ndikuar në aftësinë konkurruese të tyre. Për më tepër, tregu i punës sfidohet nga mungesa e fuqisë punëtore të aftë dhe migrimit të vazhdueshëm, gjë që ndikon drejtpërdrejt në zhvillimin e sektorit privat. Andaj, këto barrierat ndikojnë edhe në atraktivitetin e mjedisit të biznesit për investitorët e jashtëm dhe për investimet e brendshme, duke kufizuar zhvillimin ekonomik dhe përparimin në tregun global.

31 Shënim: Intensiteti i secilit indikator (barrierë) është matur përmes një shkalle intensiteti nga 0-100 ku 0 nënkupton që çështja apo indikator i caktuar nuk konsiderohet si pengesë ndërsa vlera prej 100 pikë intensiteti paraqet pengesë shumë të madhe në të bërit biznes.

● **Tabela 12.** Barrierat në mjedisin biznesor

Viti	2017	2023	2024
Normat Tatimore	57.3	63.7	51.7
Ngarkesat administrative	54.3	63.5	-
Ligjet dhe sistemi gjyqësor	52.8	55.4	47.3
Qasja në kredi	50.7	58	51.4
Kostoja e financimit	56.5	63.5	56.8
Potencialet e kufizuara të ndërmarrjes	45.9	57.5	-
Aftësitë menaxhuese	36.9	53.7	-
Sigurimi i lëndës së parë dhe pajisjeve	41.8	59.2	-
Tregu i vogël (kërkesa e vogël)	61.3	65.7	-
Qasja në informacione për ndërmarrjen	37.1	55.3	39.7
Inkasimi i borxheve	47.9	59.7	48.0
Korrupsioni	58.9	59.8	59.4
Furnizimi me energji elektrike	51.2	57.2	39.3
Transporti	35.7	51.2	35.8
Telekomunikimi	32	47.6	31.0
Siguria dhe stabiliteti politik	52.2	57.6	44.1
Administrata tatimore joefikase	53.8	62.8	52.4
Doganat	47	60.6	47.4
Procedurat e licensimit	43.8	-	39.9
Krimi dhe vjedhja	57.3	61	-
Haraçi	47.3	-	-
Aftësitë dhe arsimimi i punëtorëve	38.7	55.1	60.4
Migrimi i punëtorëve	-	75.2	64.0
Evazioni fiskal dhe informaliteti	57	63.5	64.7
Shkelja e kontratave nga konsumatorët dhe furnizuesit	-	-	48.0
Qasja në tokë	-	-	44.4
Barrierat jo tarifore	-	-	43.6
Standardet e prodhimit	-	-	42.6
Ndryshimet e shpejta teknologjike	-	-	42.1
Ligji dhe rregulloret e punës	-	-	38.4

Burimi: Anketa e Institutit Riinvest, 2024

2.2 Rregullativa ligjore dhe fiskale

Në këtë grup të barrierave janë përfshirë çështjet që kanë të bëjnë me sistemin fiskal (normat tatimore dhe administrata tatimore), perceptimi që ka të bëjë me doganat si dhe ligjet dhe sistemin gjyqësor në përgjithësi. Edhe pse shumica e bizneseve vlerësojnë që normat tatimore dhe administrata tatimore joefikase janë pengesa me intensitet të mesëm, ka një përmirësim të dukshëm në krahasim me vitin 2023. Ndryshimi në perceptimin e bizneseve ndërlihet me ngritjen e efikasitetit dhe performancën e mirë të administratës tatimore të Kosovës në mbledhjen e taksave dhe në zbatimin e rregulloreve, këtu përfshihet edhe adoptimi i ligjit në lidhje me administratën tatimore dhe procedurat. Megjithatë, mbetet sfida në vitin në vijim revizionimi i politikës tatimore në Kosovë (Komisioni Evropian, 2024). Ndërsa sa i përket doganave dy të tretat e bizneseve vlerësojnë se nuk paraqesin barrierë për bizneset. Për fund, ligjet dhe sistemi gjyqësor paraqitet si barrierë e moderuar pasi që gati shumica e bizneseve vlerësojnë si barrierë për mjedisin biznesor. Mosefikasiteti i sistemit gjyqësor ende ndikon edhe në respektimin e kontratave nga ana e konsumatorëve dhe furnizuesve, barrierë e cila vazhdon duke pasur ndikim negativ në biznese ku direkt ndikon në kostot e transaksioneve të bizneseve.

Qeveria e Kosovës ka miratuar Programin për Parandalimin e Barrës Administrative (2020–2027), iniciativë ndërinstucionale që synon të zvogëlojë barrën administrative për qytetarët, bizneset dhe shoqërinë (ZKM, 2022). Në frymë të këtij programi si pjesë e procesit të zvogëlimit të barrës, janë thjeshtuar 152 shërbime dhe eliminuar 64 të tjera. Për më tepër, ka filluar digjitalizimi i mbi 30 shërbimeve për të mundësuar një akses më të lehtë për qytetarët. Institucionet kanë thjeshtuar kufizimet në shërbime lidhur me pagesat administrative, dokumentet, kërkesat dhe vlefshmëritë. Në vitin 2022, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë ka unifikuar 15 leje që lidhen me produkte si nafta dhe gazrat, duke unifikuar tarifën në 50 euro për të gjitha këto leje. Po ashtu, Agjencia për Regjistrimin e Biznesit të Kosovës (ARBK) ndërmori veprime të ngjashme për të thjeshtësuar procedurat administrative për regjistrimin dhe ndryshimin e statusit të biznesit, duke ulur barrën dhe tarifat administrative deri në 50 përqind (ZKM, 2024). Megjithatë, mbetet ende një punë e madhe për të adrsuar edhe pengesat e barrierat e tjera në kuadër të zbatimit të këtij programi.

2.3 Qasja në financa

Edhe pse qasja në financa është përmirësuar me kalimin e viteve, ende mbetet një nga pengesat kryesore në të bërit biznes për NVM-të. Qasja në kredi ka shënuar një rënie në intesitet nga 58 në vitin 2023 në 51.4 pikë nga 100 të mundshme në vitin 2024. Sfidë tjetër për bizneset mbetet kostoja e financimit, pasi shumica e bizneseve e vlerësojnë atë si pengesë për investime.

Shtirirja e kufizuar e financimeve alternative siç është rrjeti i investitorëve engjëj paraqet një barrierë në elementare për bizneset në Kosovë (Komisioni Evropian, 2023; OECD 2024). Kosova ka nivelin më të ulët krahasuar me Vendet e Ballkanit Perëndimor në burimet alternative të financimit. Korniza e kufizuar ligjore për të rregulluar tregjet e institucioneve mikrofinanciare reflekton negativisht në rritjen dhe qëndrueshmërinë afatgjatë të sektorit (OECD 2024). Megjithatë, një aspekt i rëndësishëm i përmirësimit të qasjes në financa lidhet me Fondin Kosovar për Garanci të Kredive (FKGK) i cili është bërë një ndërmjetës i rëndësishëm financiar. Numri i kredive të garantuara nga FKGK dhe shumëllojshmëria e dritareve, kryesisht gjashtë sosh të kredive garantuara, janë rritur gjatë viteve duke mbuluar pesë sektorë (prodhimi i produkteve, ndërtim, bujqësi, pylltari dhe peshkim, tregti me shumicë dhe pakicë dhe shërbime). Në vitin 2023, kredia ndërmjetëse për NVM-të ishte 120 milionë euro e shpërndarë në 2,216 kredi dhe duke lehtësuar qasjen në financa për 1,978 NVM. Ndërsa kreditë e miratuara në fund të vitit 2023 ishin 626.4 milionë euro për 10,157 NVM në shumën kumulative të garancive prej 329.47 milionë euro. NVM-të këto kredi i kanë përdorur për investime në kapitalin qarkullues (56 përqind) ndërsa për investime kapitale 44 përqind (FKGK, 2023).

2.4 Ekonomia informale dhe korrupsioni

Informaliteti i lartë reflektohet edhe në perceptimet e bizneseve, ku krahasuar me vitin e kaluar (63.5 për qind), është shënuar një rritje prej 1.2 pikë përqindje. Edhe pse është miratuar Strategjia Kombëtare për parandalimin dhe luftimin e ekonomisë joformale, pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimeve financiare (2019-2023) (Riinvest, 2023; Qeveria e Kosovës, 2023), ndikimi i këtyre strategjive në praktikë është ende i kufizuar. Sipas Barometrit të Biznesit Ballkanik, Kosova ka një nivel prej 2.3 nga 5 pikët e mundshme, çka tregon se informaliteti konsiderohet si një pengesë e madhe për bizneset.

Informaliteti i lartë krijon një mjedis konkurrues të padrejtë, duke rritur kostot e operimit dhe duke ndikuar negativisht në rritjen dhe qëndrueshmërinë e mikro dhe bizneseve të vogla. Gjithashtu kufizon qasjen në financim, çka është thelbësore për këto biznese në fazat e hershme të zhvillimit. Për më tepër, pjesëmarrja në ekonomi informale dekurajon investimet në inovacion dhe adoptimin e teknologjive të reja, duke ulur produktivitetin e tyre.

Niveli i lartë i korrupsionit perceptohet nga bizneset vazhdon të konsiderohet si sfidë nga ana e bizneseve. Krahasuar me vitin 2023, këtë vit ka një rritje të lehtë të intesitetit (Tabela 12), ku shumica e bizneseve perceptojnë se korrupsioni është një pengesë për zhvillimin dhe të bërit biznes në Kosovë dhe e rangojnë midis 5 pengesave kryesore. Si rezultat i mungesë së politikave anti-korrupsion të përditësuar, Kosova ka rezultatin e dytë më të ulët krahasuar me ekonomitë e Vendet e Ballkanit Perëndimor. Sipas vlerësimit të OECD-së (2024) Kosova është nën mesataren e vendeve të BP në nën-dimensionet e politikave anti-korrupsion siç janë politika dhe vlerësimi i rreziqeve për korrupsionin, parandalimi i korrupsionit, integriteti i biznesit dhe përgjegjësia e korporatave, hetimi dhe ndjekja penale. Sipas OECD-së, kjo vjen për shkak të mungesës së një politike të përditësuar kundër korrupsionit. Për më tepër, pavarësisht miratimit të kuadrit ligjor në lidhje me sundimin e ligjit dhe politikën anti-korrupsion, ka pasur sfida lidhur me progresin e këtyre reformave dhe arritjen e rezultateve praktike që synojnë gjithashtu përmirësimin e kapacitetit dhe efikasitetit të institucioneve të gjyqësorit (KDI, 2024). Progresi i kufizuar në luftën kundër korrupsionit dhe dobësia në sundimin e ligjit është konfirmuar gjithashtu nga Raporti i Progresit i Komisionit Evropian (Komisioni Evropian, 2024).

2.5 Tregu i punës

Tregu i punës në gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor (BP6) karakterizohet nga punësimi në sektorin informal, mospërputhja e aftësive dhe shkathtësive me kërkesat e sektorit privat dhe migrimi i lartë (Banka Botërore, 2024a). Gjithashtu, tregu i punës karakterizohet edhe me largimin e vazhdueshëm të punëtorëve, rënien e popullsisë në moshë pune, pagat e ulëta, si dhe pjesëmarrje të ulët në tregun e punës, sidomos të grave (Banka Botërore, 2024b). Indikatorët që ndërlidhen me tregun e punës janë listuar si barrierat me intensitetin më të lartë nga ana e bizneseve. Njëra ndër to është migrimi ku për të dytin vit radhazi, edhe pse me një intensitet më të ulët në 2024 është paraqitur si barrierë e madhe për bizneset. Migrimi i lartë i fuqisë punëtore në Kosovë ngre shqetësime për humbjen e kapitalit njerëzor. Këto zhvillime në tregun e punës krijojnë nevojën urgjente për një model të ri rritjeje që synon krijimin e vendeve më cilësore të punës dhe zhvillimin e kapitalit njerëzor me qëllim ruajtjen e stabilitetit makroekonomik (Banka Botërore, 2024).

Vlerësimi më i ulët në pikë krahasuar me vitin paraprak mund të ndërlidhet me reagimin e bizneseve për t'u përballur me ikje të punëtorëve. Të dhënat nga studimi i Riinvest (2023) tregojnë se 79 përqind e bizneseve kanë rritur pagat mesatarisht prej 22 përqind në vitin 2023 dhe një të tretat e bizneseve (37 përqind) kanë planifikuar të rrisin pagat, gati një e katërta e bizneseve planifikojnë të përmirësojnë kushtet e punës, 20.6 përqind planifikojnë të punësojnë gra dhe 10.4 përqind planifikojnë të investojnë në teknologji të re për automatizimin e punës.

Krahas migrimit, mungesa e aftësive dhe shkathtësive të punëtorëve vlerësohet si barrierë e madhe për bizneset. Në dy vitet e fundit në gjetjet e anketës me biznese shumica e bizneseve kanë vlerësuar se punëtorëve iu mungojnë aftësitë dhe shkathtësitë që kërkohen në vendin e punës. Këto gjetje korrespondojnë me studimin e Riinvest dhe ASHAK (2023)- studim i cili ka adoptuar metodologjinë e Forumit Ekonomik Botëror-WEF mbi Indeksën e Konkurrueshmërisë Globale-GCI, tregon se Kosova është në vendin e 118-të me 45 pikë nga 100 për kapitalin social, ndërsa sa i përket shtyllës së aftësive është në vendin e 58-të me 67.4 pikë.

Poashtu, Kosova renditet e 90-ta nga 142 shtete me një 46.9 pikë nga 100 për cilësinë e formimit profesional (ASHAK, 2023). Për të trajtuar mospërputhjen e aftësive, qeveria miratoi disa strategji si Strategjia e Punësimit 2024–28 (Qeveria e Kosovës, 2024), dhe Strategjia e Arsimit 2022–2026 (MESTI, 2022) si dhe masa përmes Programit të Reformës Ekonomike (Qeveria e Kosovës, 2024) për të synuar ngushtimin e hendekut të aftësive të dukshme në tregun e punës. Megjithatë deri tani nuk ka pasur rezultate të prekshme sa i përket zbatimit të dokumenteve strategjike.

2.6 Barrierat administrative dhe infrastruktura

Pas krizës energjetike të shkaktuar nga lufta në Ukrainë, krahasuar me vitin e kaluar ku shumica e bizneseve kanë konsideruar si barrierë furnizimin me energji elektrike, gjetjet e anketës tregojnë që vetëm një e treta e bizneseve e konsiderojnë me intensitet mesatar. Kjo vlerësohet edhe në raportin e progresit të Komisionit Evropian si një arritje, që është edhe falë progresit të arritur të paketës për mbështetje të efijencës së energjisë që mbështetë ekonomitë familjare dhe sektorin privat financiar nga Bashkimi Evropian (Komisioni Evropian, 2024). Krahasuar me vitin 2014 vërejmë një vlerësim pozitiv nga ana e bizneseve sa i përket procedurave të licencimit. Në nën dimensionet e politikave të transportit të studimit të OECD (2024) siç janë planifikimi vlerësohet se Kosova është mbi mesataren e vendeve të Ballkanit Perëndimor, përjashtim bën nën-dimensionin i planifikimit dhe menaxhimit. Sa i përket telekomunikimit, Kosova në vitin 2023 ka arritur t'i ndërlidhë vendbanimet rurale me infrastrukturën e internetit. Këto gjetje të studimit të OECD, janë konfirmuar edhe nga gjetjet e anketës ku bizneset vlerësojnë së transporti dhe telekomunikimi përbëjnë barrierë me intensitet të ulët.

2.7 Barrierat e brendshme

Përveç barrierave në mjedisin e jashtëm të biznesit, bizneset në Kosovë ballafaqohen edhe me barrierë që ndërlidhen me faktorët brenda biznesit. Këto barrierë reflektojnë direkt në aftësinë e biznesit për të konkuruar jo vetëm në nivel nacional por edhe në atë ndërkombëtar. Ajo që mund të shihet si një ndryshim pozitiv nga huultimet e mëhershme është s dy vitete fundit udhëheqësit e kompanive po e vërejnë gjithnjë e më shumë si pengesë aftësitë dhe arësimimin e pamjaftueshëm të punëtorëve dhe aftësitë menaxheriale. Në gjetjet e anketës për këtë vit, ndryshimet e shpejta teknologjike janë vlerësuar si barrierë me intensitet të ulët, gjë që ndërlidhet me mungesën e një strategjie brenda biznesit se si t'i përgjigjen dinamikës së shpejtë të këtyre ndryshimeve përmes aftësisë së tyre për t'ju përshtatur këtyre ndryshimeve. Ndërsa krahasuar me vitin e kaluar ku qasja në informacion është vlerësuar si barrierë me intensitet mesatar, këtë vit ka një rënie të ndjeshme dhe është vlerësuar si barrierë me intensitet të ulët. Ky është një indikacion i qartë, që për të pasur qasje në informacion bizneset duhet t'i zhvillojnë aftësitë e rrjetëzimit, në vendet në tranzicion si Kosova, rrjetëzimi është një strategji biznesi e domosdoshme për të përballuar një mjedis biznesi të pasigurt, duke siguruar një avantazh konkurrues përmes qasjes në burime dhe, si rezultat, duke ndikuar në rritjen e biznesit. Standardet e prodhimit përbëjnë për bizneset barrierë me intensitet mesatar. Kjo ndërlidhet jo vetëm me mungesën e investimeve brenda biznesit në teknologjinë e fundit, por edhe me mungesën e trupave të certifikimit për produktet me qëllim eksportet. Për këtë qëllim, Plani i Rritjes i Qeverisë ka paraparë që do të mbështesë me 6 laboratorë testimi të mbështetur dhe 4 trupa certifikues të mbështetur dhe të gatshëm për të ofruar akreditim ndërkombëtar.

INVESTIMET

3

3.1 Vëllimi, dinamika dhe struktura e investimeve

Dinamika dhe cilësia e rritjes ekonomike dhe përgjithësisht e zhvillimit ekonomik e social përcaktohet sidomos me vëllimin e cilësinë e aktivitetit investues. Vëllimi ka të bëjë me thellësinë apo peshën e investimeve bruto në PVB (Investimet si përpjesë e PVB-së), që shprehet në përqindje. Vendet që realizojnë një përqindje më të madhe investimesh nga PVB synojnë normë më të lartë rritjeje dhe zakonisht janë

në një stad më të ultë zhvillimi. Por rritja ekonomike nuk varet vetëm nga vëllimi që investohet edhe nga cilësia e investimeve, pra nga efikasiteti i investimeve dhe kontributi i tyre marginal për rritjen e PVB. Efikasiteti varet nga cilësia e procesit përgatitor të vendimeve investive, vlerësimi i kostove dhe përfitimeve dhe gjithashtu se si zbatohen projektet që aprovohen dhe gjithashtu edhe nga eksploatimi i suksesshëm gjatë periudhës së përdorimit të tyre. Tabela 13 pasqyron normën e investimeve në Kosovë e dhe vendet e rajonit.

● **Tabela 13.** Investimet bruto si përpjesë e PVB-së në Kosovë dhe vendet rajonit (përqind)

	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	Mesatarja
Bosnja dhe Hercegovina	22.5	21.7	22.7	24.6	24.4	24.8	23.1	26.1	27.4	26.8	24.4
Mali i Zi	20.2	20.1	26.1	30.2	31.9	32.0	31.2	26.7	30.3	27.6	27.6
Maqedonia e Veriut	30.3	30.4	32.5	32.3	32.3	34.3	29.9	32.2	36.0	29.6	32.0
Shqipëria	25.7	25.8	25.2	25.1	23.9	23.0	23.0	24.8	20.9	18.6	23.6
Serbia	16.5	18.5	18.2	19.7	22.5	24.9	24.1	24.9	26.4	24.6	22.0
Kosova	27.8	30.4	33.5	34.7	36.3	34.6	33.4	36.0	35.2	33.9	33.6

Burimi: Eurostat, 2024

Kosova ka mesataren më të lartë të Pjesës së Formimit të Brendshëm të Kapitalit (33.6 përqind) në Ballkanin Perëndimor për periudhën 2014–2023. Megjithatë, kjo pjesë e lartë nuk është reflektuar në ritme të larta të rritjes ekonomike, duke ngritur pikëpyetje mbi efikasitetin e përdorimit të këtyre investimeve dhe ndikimin e tyre në produktivitet. Maqedonia e Veriut (32.0 përqind) gjithashtu ka nivel të lartë të investimeve, ndërsa Mali i Zi (27.6 përqind) shfaq variacione të theksuara, kryesisht për shkak të projekteve të mëdha infrastrukturore. Bosnja dhe Hercegovina (24.4 përqind) dhe Shqipëria (23.6 përqind) mbajnë nivele relativisht të qëndrueshme, ndërsa Serbia (22.0 përqind) ka nivelin më të ulët të investimeve si pjesë e PVB-së. Siç u evidentua më lartë, dhe do të trajtohet edhe në seksionin 3.3, përqindjet e larta

të investimeve nuk janë gjithmonë të mjaftueshme për të nxitur zhvillim të qëndrueshëm ekonomik pa një planifikim dhe menaxhim efektiv. Këto të dhëna nënvizojnë rëndësinë e jo vetëm shtimit të investimeve, por edhe përmirësimit të cilësisë së tyre për të siguruar një ndikim të qëndrueshëm dhe të matshëm në rritjen ekonomike dhe zhvillimin e qëndrueshëm. Efikasiteti i investimeve mbetet një sfidë kyçe për Kosovën dhe rajonin në tërësi.

Investimet e përgjithshme përfshijnë, investimet e sektorit privat, investimet qeveritare dhe të ndërmarrjeve publike dhe investimet e jashtme duke përfshi këtu edhe diasporën. Një pasqyrë e këtyre investimeve në vitin 2023 jepet në Tabelën 14.

● **Tabela 14.** Investimet në Kosovë në vitin 2023 (në miliona Euro)

	A		B	
	2023	Proporcioni (%)	2023	Proporcioni (%)
1. Investimet qeveritare	554	24	554	18
2. Investimet e ndërmarrjeve publike	85	4	85	3
3. Investimet e sektorit privat	817*	36	1600**	52
4. IJD	840	37	840	27
5. Totali dhe struktura në %	2296	100	3079	100

Burimi: 1 – Qeveria e Kosovës; 2 – Njësia për monitorimin e ndërmarrjeve publike; 3 – *ATK, **Anketa e Institutit Riinvest; 4 – BQK.

Sipas këtyre të dhënave, niveli i investimeve në Kosovë vlerësohet të jetë rreth 2.3 miliardë Euro. Ky kalkulim bazohet të të dhënat administrative të raportuara nga institucionet relevante. Nëse për nivelin e investimeve të sektorit privat përdorim të dhënat e Institutit Riinvest të ekstrapoluara për të përfshirë gjithë popullacionin, atëherë niveli i investimeve arrin në afërsisht 3.1 miliardë Euro. Kjo shumë është, edhe pse është më afër nivelit të vlerësuar të investimeve bruto në Kosovë në vlerësimet e PVB-së nga ASK, FMN, Banka Botërore, Banka Qendrore, dhe Qeveria, ende ka një diskrepancë. Kjo evidenton rëndësinë e përmirësimit të informacionit statistikor, veçanërisht për pjesën e investimeve të sektorit privat.

Investimet publike

Të dhënat mbi buxhetimin dhe realizimin e investimeve kapitale në Kosovë për periudhën 2019–2024 (të diskutuara në detaje në seksionin 1.5), evidentojnë se, megjithëse buxheti i investimeve ka shfaqur një rritje domethënëse, me një rritje nga 789 milionë euro në vitin 2019 në 857 milionë euro në vitin 2023, realizimi i këtyre investimeve ka mbetur shumë prapa. Gjatë kësaj periudhe, rreth 1.3 miliardë euro të planifikuara për investime kapitale nuk u shpenzuan. Përqindja e ulët e realizimit evidenton sfida të theksuara në procesin planifikimit dhe zbatimit.

Mosrealizimi i investimeve kapitale të planifikuara ka pasoja të mëdha për ekonominë dhe shoqërinë e Kosovës. Ky nivel i ulët i realizimit të investimeve kufizon potencialin e rritjes ekonomike. Edhe pse niveli i efikasitetit të investimeve në Kosovë është i ulët, rritja e investimeve megjithatë do të mundësonte rritje më të madhe ekonomike. Gjithashtu, investimet e papërdorura kufizojnë kapacitetin e ekonomisë për të përballuar inflacionin, pasi përmirësimi i infrastrukturës dhe produktivitetit mund të ndihmonte në uljen e kostove të prodhimit dhe të shërbimeve. Mungesa e këtyre investimeve gjithashtu kufizon efektet anësore në sektorë të tjerë ekonomikë, si ndërtimi, tregtia dhe shërbimet, duke kufizuar përfitime më të gjera në ekonomi. Për më tepër, mungesa e financimit të projekteve që synojnë përmirësimin e shërbimeve publike si arsimit, shëndetësia dhe transporti ndikon negativisht në cilësinë e jetës së qytetarëve dhe kufizon qasjen e tyre ndaj shërbimeve bazë.

Për të maksimizuar përfitimet ekonomike dhe shoqërore, është thelbësore të përmirësohet kapaciteti për realizimin e projekteve kapitale dhe të adresohen sfidat institucionale që pengojnë zbatimin e buxhetit kapital.

Në pesë vitet e fundit, investimet private kanë qenë një shtytës i rëndësishëm i rritjes ekonomike. Investimet publike, në pesë vjetët e fundit, kanë regjistruar trendin më të ulët në dekadën e fundit – edhe nëse e shikojmë në vlerë monetare. Pavarësisht mungesës së infrastrukturës në vend, investimet kapitale nuk kanë pasur peshën kryesore në buxhetin e shtetit. Në vitin 2013, ato ishin kategoria kryesore e shpenzimeve, por nga viti 2014 deri në 2019, shpenzimet qeveritare u dominuan nga pagat dhe mëditjet. Prej vitit 2020, subvencionet dhe transferet kanë përbërë kategorinë më të madhe të shpenzimeve, duke arritur në mbi një miliard euro.

Ky zhvendosje drejt subvencioneve dhe transfereve, në vend të investimeve kapitale, ndikon negativisht në rritjen ekonomike afatgjatë. Ndryshe nga investimet kapitale, të cilat nxisin zhvillimin e infrastrukturës dhe përmirësojnë produktivitetin e përgjithshëm të ekonomisë, subvencionet dhe transfertat zakonisht shkojnë për shpenzime afatshkurtra pa krijuar kapacitete të reja prodhuese. Kjo ul potencialin e ekonomisë për rritje të qëndrueshme, duke kufizuar ndikimin që mund të kishin investimet afatgjata në sektorë strategjikë. Në këtë mënyrë, ekonomia bëhet më pak konkurruese dhe më e varur nga financimet publike, ndërkohë që ndikimi i drejtpërdrejtë në rritje dhe zhvillim mbetet i kufizuar.

Ndërmarrjet publike qendrore

Ndërmarrjet publike qendrore (NP-të) në Kosovë gjatë vitit 2023 kanë realizuar rreth 306 milion euro³² të hyra ose rreth 3.2 përqind të PBB-së. Gjatë pesë viteve të fundit, NP-të Kosovë kanë realizuar investime kapitale të konsiderueshme në vlerë prej rreth 307.5 milionë euro (Tabela 15). KEK-u, me investime që arrijnë në qindra miliona euro, ka qenë ndërmarrja me më së shumti investimet, nërsa ndërmarrjet e tjera si Telekom, Trainkosi, Infrakosi, dhe Posta e Kosovës kanë pasur investime më modeste.

32 Në këtë kalkulim nuk janë përfshirë të hyrat nga KMDK, për shkak të mungesës së të dhënave për vitin 2023. Raporti Vjetor për vitin 2023 dhe auditimet financiare ende nuk janë publikuar.

● **Tabela 15.** Realizimi i projekteve kapitale

Realizimi i projekteve kapitale					
NPQ	2019	2020	2021	2022	2023
Posta e Kosovës	139,118.00	103,518.00	94,802.00	234,399.00	628,889.00
Ibër Lepenci	381,794.00	228,069.00	451,954.00	438,599.00	223,347.00*
Infrakos	1,419,626.82	69,542.77	40,847.16	311,138.75	278,841.67
KEKU	70,151,493.00	77,046,673.00	79,315,845.00	46,275,928.00	151,985,531.00*
Telekomi	3,650,000.00	-	883,000.00	16,678,000.00	7,375,000.00
Trainkos	197,577.00	245,099.00	442,840.00	247,479.00	192,124.00
Trepça	-	1,437,250.00	34,000.00	36,553,554.00	39,376,108.50
KMDMK	933,305.00	666,000.00	1,005,376.00	1,441,669.00	1,012,423.00


Burimi: Raportet vjetore apo planet e buxhetit të NPQ-të³³

Pavarësisht këtyre investimeve, performanca e shumicës së këtyre ndërmarrjeve ka mbetur e dobët, duke treguar humbje financiare vit pas viti (Figura 6). Kjo sugjeron se investimet kapitale të realizuara nuk kanë arritur ende të përmirësojnë efikasitetin operativ dhe qëndrueshmërinë financiare të këtyre ndërmarrjeve, edhe për shkak të faktorëve të tjerë si qeverisja e dobët korporative, keqmenaxhimi, dhe mungesa e inovacionit. Përrjashtimisht, gjatë vitit 2023, Telekomi i Kosovës ka pasur fitim prej rreth 7 milionë euro, një arritje

domethënëse pas disa viteve të vazhdueshme me humbje. Gjithashtu, performanca pozitive financiare e KEK-ut është e dukshme; megjithatë, kjo situatë është disi specifike për shkak të rritjes së kërkesës për energji elektrike dhe rritjes së çmimeve të energjisë pas luftës në Ukrainë. Tensionet gjeopolitike kanë ndikuar tregjet energjetike globalisht, duke rritur çmimet dhe duke krijuar një mjedis të favorshëm për prodhuesit e energjisë si KEK.

33 Shënim*: *Për Ndërmarrjen Trepça dhe KMDMK, si dhe të dhënat për vitin 2023 të KEK-ut dhe Ibër Lepencit, janë evidentuar të dhënat nga buxheti i planifikuar për investimet kapitale, në mungesë të të dhënave për realizimin e tyre. Këto të dhëna nuk janë përfshirë kur është kalkuluar investimi i realizuar prej 307 milionë eurove. Nëse llogariten edhe këto investime, atëherë shuma do të arrinte vlerën prej afërsisht 390 milionë eurove.*

● FIGURA 7. Përmbledhja e fitimit/Humbjes NET për NPQ (2019-2023)



Shumica e investimeve të NP-ve janë financuar nga këto kompani, megjithatë, një pjesë domethënëse është financuar nga buxheti i Republikës së Kosovës. Nga totali prej rreth 59 milionë eurosh të transferuar nga qeveria e Kosovës për ndërmarrjet publike qendrore gjatë pesë viteve (2019-2023), vetëm rreth 9.4 milionë euro janë dhënë në formën e investimeve kapitale, ndërsa pjesa tjetër përbëhet nga subvencione. Kjo strukturë financimi tregon një mbështetje të madhe për këto ndërmarrje për të mbuluar kostot operationale, por me pak fokus në rritjen e kapaciteteve ose përmirësimin e infrastrukturës përmes investimeve afatgjata. Ky model mund të krijojë varësi nga qeveria dhe të kufizojë zhvillimin e qëndrueshëm të ndërmarrjeve, pasi subvencionet mbulojnë shpenzimet e përditshme por nuk adresojnë nevojat për modernizim dhe efikasitet. Në afat të gjatë, mungesa e investimeve kapitale mund të ndikojë negativisht në performancën e ndërmarrjeve, duke i bërë ato më pak konkurruese

dhe duke rritur presionin për mbështetje të vazhdueshme financiare nga qeveria.

Sektori privat

Të dhënat mbi investimet në Kosovë nga viti 2019 deri në gjysmën e parë të vitit 2024 tregojnë se investimet janë rritur ndjeshëm gjatë këtyre viteve. Sipas të dhënave të ATK-së, investimet janë rritur nga 392.9 milionë në vitin 2019 në 817.4 milionë në vitin 2023. Të dhënat për vitin 2024, të cilat reflektojnë vetëm gjashtë muajt e parë, kanë arritur tashmë 449.8 milionë. Nëse ky trend vazhdon, investimi total për vitin 2024 mund të tejkalojë nivelin e viteve të kaluara. Këto të dhëna konfirmohen edhe nga anketa e Institutit Riinvest. Për më tepër, pritjet e bizneseve për vitin 2025 janë që investimet do të rriten për rreth 20 përqind.

Tre sektorët kryesorë që kanë mobilizuar më shumë investime gjatë kësaj periudhe janë Tregtia me shumicë dhe pakicë, Ndërtimtaria, dhe Industria përpunuese, duke reflektuar edhe kompozicionin e ekonomisë së Kosovës. Përderisa niveli i investimeve është rritur ndjeshëm, struktura e investimeve private në Kosovë, me fokus të madh në sektorët e tregtisë dhe ndërtimtarisë, përbën disa sfida për zhvillimin afatgjatë ekonomik. Ky prirje drejt sektorëve që të ndjeshëm ndaj cikleve ekonomike mund të rrisë paqëndrueshmërinë ekonomike, duke krijuar një varësi nga kërkesa konsumatore dhe dërgesa nga diaspora. Mungesa e investimeve të konsiderueshme në sektorë të tjerë prodhues dhe me vlerë të shtuar, mund të pengojë diversifikimin ekonomik dhe të

kufizojë kapacitetin e Kosovës për të ndërtuar një bazë prodhuese të qëndrueshme.

Për më tepër, përqendrimi në tregti dhe ndërtimtari nuk kontribuon shumë në inovacion apo në rritjen e produktivitetit afatgjatë. Investimet e kufizuara në sektorët me potencial për zhvillim teknologjik, si industria përpunuese dhe aktivitetet shkencore e teknike, lënë pak hapësirë për rritjen e qëndrueshme. Kjo mungesë diversifikimi rrit rrezikun e ekonomisë për t'u përballur me vështirësi gjatë periudhave të krizave ekonomike globale ose ndryshimeve strukturore, duke e bërë atë më të ndjeshme ndaj goditjeve të jashtme dhe duke kufizuar potencialin për zhvillim të qëndrueshëm dhe inovacion.


Pesha e madhe e sektorit të ndërtimit në ekonominë e Kosovës, që përfaqëson mbi 17 përqind të investimeve totale, përbën 8 përqind të PBB-së dhe 10 përqind të qarkullimit të kompanive, paraqet rreziqe të rëndësishme për ekonominë e vendit. Bum-i në ndërtim, i nxitur nga kërkesa e diasporës dhe i mbështetur nga financimi i vazhdueshëm bankar, ka çuar çmimet e pasurive të paluajtshme në nivele gjithnjë e më të larta. Megjithatë, sipas regjistrimit të fundit të popullsisë, rreth 40 përqind të banesave/njësive të banimit janë të zbrazëta, gjë që tregon qartë se ka një ofertë të tepërt në tregun e banesave, që sugjeron se një pjesë e madhe e kërkesës mund të jetë spekulative dhe jo e bazuar në nevoja reale për banim. Kjo dinamikë krijon rrezikun e një fluske në tregun e pasurive të paluajtshme, ku çmimet e larta mund të pësojnë një rënie të papritur nëse ulet kërkesa nga diaspora ose kufizohet financimi bankar. Një rënie e tillë do të dëmtonte jo vetëm sektorin e ndërtimit dhe patundshmërive, por mund të kishte pasoja edhe në sektorin bankar, duke rritur kreditë e këqija dhe duke ndikuar në stabilitetin financiar. Gjithashtu, për shkak se çmimet e pasurive të paluajtshme në Kosovë diktohen në masë të madhe nga kërkesa e diasporës dhe investitorëve të huaj, banorët rezidentë kanë vështirësi të përballojnë blerjen e një shtëpie apo apartamenti. Për më tepër, kjo varësi e madhe nga ndërtimi devijon burimet nga sektorë të tjerë produktivë, gjë që mund të pengojë diversifikimin ekonomik dhe ekspozon ekonominë ndaj goditjeve të jashtme. Shkalla e lartë e banesave/njësive të banimit të pashfrytëzuara, e kombinuar me çmimet në rritje, ngre gjithashtu shqetësime për alokimin joefikas të kapitalit, pasi burimet përqendrohen në asetë të pashfrytëzuara në vend të sektorëve që mund të gjenerojnë rritje të qëndrueshme dhe punësim. Po ashtu, fokusi në sektorë si ndërtimtaria, që janë sektorë jo të tregtueshëm, përkeqëson deficitin tregtar të Kosovës.

3.2 Efikasiteti i investimeve dhe rritja ekonomike

Gjatë dekadës së fundit, pjesëmarrja e Formimi te Bruto Kapitalit Fiks (ang. Gross Fixed Capital Formation) (GFCF) në PVB-të e Kosovës ka shfaqur një rritje graduale, duke ar-

ritur nga 28 përqind (në vitin 2014) në 33 përqind (në vitin 2021) përpara se të stabilizohej rreth 31 për qind në vitet vijuese (Figura 7). Ky trend tregon se Kosova ka ndarë një pjesë gjithnjë e më të madhe të burimeve të saj ekonomike për investime në kapitalin fiks, të cilat janë thelbësore për rritjen ekonomike afatgjatë dhe zhvillimin e infrastrukturës.³⁴

● Figura 8. Formimi i bruto kapitalit fiks në raport me PBB-në në Kosovë



Burimi: ASK, 2024

³⁴ Mesatarja 10-vjeçare e pjesës së GFCF-së si përqindje e PBB-së në vendet e Ballkanit Perëndimor tregon se Kosova ka pjesën mesatare më të lartë me 30 përqind, e ndjekur nga Mali i Zi dhe Shqipëria me 24 përqind, Maqedonia e Veriut me 23 përqind, Bosnja dhe Hercegovina me 22 përqind dhe Serbia me pjesën më të ulët prej 20 përqind.

Megjithatë, pavarësisht rritjes së pjesës së GFCF-së, norma e përgjithshme e rritjes ekonomike të Kosovës ka mbetur relativisht e ulët, me një mesatare prej 4 përqind. Kjo sugjeron se, ndonëse më shumë burime po drejtohen drejt investimeve, produktiviteti ose efikasiteti i këtyre investimeve nuk është përmirësuar në mënyrë proporcionale. Kjo tregon se ka sfida strukturore ose joefikasitet në përkthimin e investimeve në rritje më të shpejtë.

Për të vlerësuar produktivitetin e kapitalit në Kosovë, ne kemi përdorur raportin inkremental të kapitalit dhe outputit (ang. Incremental Capital-Output Ratio) (ICOR)³⁵, i cili lidh nivelet e investimeve me ndryshimet në PVB për periudhën 2015 deri në 2023. Qëllimi është të kapim ndryshimet afatmesme në ICOR-it dhe të shqyrtojmë marrëdhënien midis nivelit të kapitalit dhe rritjes së prodhimit. Në këtë kontekst, ICOR ndikohet nga disa faktorë, përfshirë ritmin e përparimit teknologjik, zhvillimin e aftësive profesionale dhe menaxheriale dhe cilësinë e strukturave organizative brenda ekonomisë.

Ndryshe nga një fokus i ngushtë mbi investimet e reja, ICOR përveç se konsideron të ardhurat e gjeneruara nga investimet e reja, poashtu konsideron edhe produktivitetin e aseteve ekzistuese. Kjo për faktin se ndryshimi në PBB (emëruesi në këtë rast), reflekton produktivitetin e gjithë stokut të kapitalit. Duke qenë se asetet ekzistuese janë shpesh më të mëdha sesa kapitali i shtuar çdo vit, ICOR reflekton efikasitetin e të gjithë stokut të kapitalit dhe jo vetëm të investimeve të fundit. Për shembull, një rënie e shfrytëzimit të kapaciteteve, mund të çojë në një rritje të ICOR-it, edhe nëse investimet e reja janë produktive. Kjo do të thotë që ICOR në Kosovë mund të rritet jo për shkak të mungesës së efikasitetit në investimet e reja, por për shkak të sfidave në shfrytëzimin e plotë të aseteve ekzistuese. Në fakt, të dhënat nga anketa, e realizuar për qëllim të këtij studimi, evidenton se shfrytëzimi mesatar i kapaciteteve nga bizneset është rreth 61 përqind. Kjo nënkupton që shumë kompani nuk e përdorin të gjithë potencialin e kapaciteteve të tyre ekzistuese, gjë që çon në uljen e efikasitetit të investimeve dhe, rrjedhimisht, në një ICOR më të lartë, që do të thote se perdoret me shume kapital fikxs per te ariitur nje norme te caktuar te aoutputit, per-


katesisht GDP. Shfrytëzimi i ulët i kapaciteteve mund të jetë rezultat i sfidave të kërkesës së pamjaftueshme, mungesës së burimeve të kualifikuara ose kushteve të pafavorshme të tregut, duke sugjeruar se përmirësimi i shfrytëzimit të kapaciteteve mund të kontribuojë në uljen e ICOR-it dhe rritjen e efikasitetit të kapitalit në vend.

Për të pasur një pamje më të mirë të ICOR-it të Kosovës, i njëjti është vendosur në një perspektivë rajonale duke e krahasuar me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor (Figura 8). Vlerat e ICOR-it evidentojnë dallime të mëdha në efikasitetin e kapitalit në rajon. Kosova veçohet me ICOR-in më të lartë prej 4.62, që tregon se ajo kërkon investime kapitali ndjeshëm më të mëdha për të gjeneruar rritje ekonomike në krahasim me fqinjët e saj. Në anën tjetër, Serbia ka ICOR-in më të ulët prej 2.21, që sugjeron një efikasitet relativisht të lartë në shndërrimin e investimeve në prodhim ekonomik. Shqipëria dhe Mali i Zi gjithashtu tregojnë një efikasitet mesatar, me vlera të ICOR-it prej 2.50 dhe 2.96, përkatësisht. Bosnja dhe Hercegovina (3.36) dhe Maqedonia e Veriut (3.92) kanë ICOR më të larta, por mbeten më efikase se Kosova. Këto shifra nënkuptojnë se Kosova përballet me sfida strukturore në produktivitetin e kapitalit, të cilat mund të pengojnë rritjen e saj ekonomike në krahasim me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor. Zgjidhja e këtyre joefikasiteteve mund të përfshijë masa për të përmirësuar shfrytëzimin e kapaciteteve, përmirësimin e strukturës teknike të investimeve, aftësitë e fuqisë punëtore dhe produktivitetin e përgjithshëm për të afruar efikasitetin e kapitalit të Kosovës me standartet rajonale.

35 ICOR për periudhën i (2015) deri në j (2023) është i përcaktuar si raporti i shumës së investimeve gjatë periudhës $i-1$ deri në $j-1$ (të shprehura në terma të GFCF-së), në raport me prodhimin (të shprehur në terma të PBB-së) në periudhën j minus prodhimin në periudhën i .

$$ICOR = \frac{\sum_{2014}^{2022} GFCF}{GDP_{2023} - GDP_{2015}}$$

● **Figura 9.** ICOR në vendet e Ballkanit Perëndimor



Burimi: Autorët në bazë të të dhënave të publikuara nga EUROSTAT, 2024

ICOR i lartë në Kosovë sugjeron joefikasitete të brendshme në mënyrën se si përdoret kapitali, pjesërisht për shkak të shfrytëzimit të ulët të kapaciteteve të bizneseve të evidentuar më sipër apo edhe produktivitetin e ulte të punës në shfrytëzimin e këtij kapitali. Gjithashtu, ndryshe nga vendet me infrastrukturë më të zhvilluar dhe sektorë të pjekur, Kosova mund të shfaqë një ICOR relativisht të lartë edhe për shkak të nevojave të saj të vazhdueshme për përmirësim të infrastrukturës. Për më tepër, struktura teknike e investimeve të bizneseve në Kosovë gjatë periudhës 2023 deri në 2025 nga rezultatet e anketës ilustron disa arsye që sqarojnë ICOR-in e lartë (Tabela 16). Në vitin 2023, një pjesë e madhe e investimeve është përqendruar në asete më pak produktive, me 58.4 përqind të alokuara për ndërtesa të reja dhe 29.7 përqind për tokë, ndërkohë që vetëm një pjesë e vogël është drejtuar drejt makinerive dhe pajisjeve (4 për qind) dhe kërkimit dhe zhvillimit (0.16 për qind). Kjo shpjegon se kapitali është drejtuar drejt aseteve

që, ndonëse të rëndësishme për zgjerimin e biznesit, nuk rrisin menjëherë produktivitetin, çka çon në një ICOR më të lartë. Megjithatë, të dhënat tregojnë se investimet priten të rriten, me një zhvendosje drejt aseteve më produktive në vitet e ardhshme. Konkretisht, pjesa e investimeve në makineri dhe pajisje pritet të rritet ndjeshëm, nga 4 për qind në 2023 në 22.6 për qind deri në 2025. Kjo zhvendosje është premtuese, pasi investimet në makineri dhe pajisje kanë tendencë të kenë një ndikim të drejtpërdrejtë në produktivitet dhe prodhim, çka mund të ndihmojë në uljen e ICOR-it me kalimin e kohës. Pjesa në rënie e investimeve në ndërtesa dhe tokë sugjeron një rialokim të burimeve drejt aseteve që japin më shumë produktivitet, duke u përshtatur më mirë me nevojën e Kosovës për përdorim efikas të kapitalit. Ky fokus në asete më produktive, nëse realizohet, mund të kontribuojë në përmirësimin e efikasitetit të kapitalit dhe në rritjen e përgjithshme ekonomike në Kosovë.

● **Tabela 16.** Struktura teknike e investimeve në Kosovë (përqind)


	2023	2024	2025	Trendi
Tokë	29.69	30.33	16.72	
Ndërtesa të reja	58.43	57.17	49.64	
Makineri dhe pajisje	4.02	8.51	22.63	
Kërkim dhe zhvillim	0.16	0.14	0.38	
Trajnime; Konsulenca	0.44	0.33	0.34	
Kapital punues/qarkullues	6.98	3.01	7.69	
Investime tjera	0.28	0.50	2.60	

Burimi: Anketa e Institutit Riinvest, 2024

Struktura teknike e investimeve gjithashtu zbulon se shpenzimet për kërkim dhe zhvillim mbeten shumë të ulëta, me vetëm 0.16 për qind të alokuara në 2023 dhe një rritje të lehtë në 0.38 për qind të planifikuar për 2025. Megjithëse modeste, ka një shenjë pozitive me investimet në kërkim dhe zhvillim që pritet të rriten gjë që sugjeron një vetëdijesim në rritje të rëndësishme të kërkimit dhe zhvillimit për të nxitur inovacionin dhe konkurrueshmërinë afatgjatë. Nëse ky trend vazhdon, edhe rritje të vogla në kërkim dhe zhvillim mund të kontribuojnë në përmirësimin e produktivitetit dhe uljen e ICOR-it në të ardhmen, pasi inovacioni mund të nxisë një përdorim më efikas të kapitalit në sektorë të ndryshëm.

Në përgjithësi, megjithëse ICOR është një tregues informues, interpretimi i tij për Kosovën kërkon edhe analizë të përbërjes sektoriale, gjë që ndikon në kuptimin më të mirë të produktivitetit të kapitalit. Duke u bazuar në të dhënat e anketës dhe të dhënave të ATK-së për shpërndarjen sektoriale të investimeve, dhe të dhënave të ASK-së në lidhje me kontributin e secilit sektor në PBB, ne kemi kalkuluar ICOR-in për secilin sektor në bazë të klasifikimit NACE (një shifror) (Figura 9).

● **Figura 10.** ICOR sipas sektorëve



Burimi: Autorët në bazë të të dhënave nga ASK-së dhe ATK-së

Të dhënat sugjerojnë se në Kosovë ka dallime domethënëse në nivelin e ICOR-it nëpër sektorë të ndryshëm. Sektorët me ICOR të ulët dhe raporte të ulëta të investimeve ndaj qarkullimit, si sektori financiar dhe arsimit, janë shumë efikasë, duke kërkuar investime minimale për të gjeneruar prodhim dhe të ardhura të konsiderueshme. Në anën tjetër, sektorët me ICOR të larta, si ndërtimtaria, dhe energjia kërkojnë investime të mëdha kapitale, të cilat nuk përkthehen në mënyrë efektive e të shpejta në prodhim, për shkak të kostove të larta të infrastrukturës, kohës së kthimit, dhe sfidave operacionale. Sektorët me ICOR të moderuar, si prodhimi dhe akomodimi, kërkojnë diversifikim të investimeve dhe shfrytëzim më të lartë të kapaciteteve.

Kjo ndarje mund të informojë prioritizimin e investimeve në sektorë ku kapitali përdoret më në mënyrë më efektive, ndërsa zbatohen reforma në sektorët me ICOR të larta për të reduktuar joefikasitetin dhe për të maksimizuar prodhimin ekonomik. Pavarësisht ICOR-it të lartë në disa sektorë për shkak të kostove fillestare të infrastrukturës [p.sh., shërbimi

met energjetike dhe infrastruktura e transportit], ata janë të rëndësishëm për zhvillimin afatgjatë të Kosovës. Investimet strategjike në këta sektorë mund të lehtësojnë një rritje të qëndrueshme dhe të balancuar ekonomike.

Të dhënat sektoriale mbi investimet, kontributin në PBB dhe qarkullimin sipas sektorëve (Tabela 17) në Kosovë tregojnë një ekonomi të mbështetur kryesisht në tregtinë me shumicë dhe pakicë dhe ndërtimtarinë. Tregtia përfaqëson 31.23 përqind të investimeve, 14 përqind të PVB-së dhe 53 përqind të qarkullimit, duke reflektuar një treg të fuqishëm konsumator, por krijon një varësi të rrezikshme nga kërkesa e konsumatorit. Ndërtimtaria përbën 17.13 përqind të investimeve, por kontribuon vetëm 8 përqind në PBB, për shkak të natyrës së saj që kërkon më shumë kapital dhe ndikimit të saj të vonuar ekonomik. Kjo varësi nga tregtia dhe ndërtimtaria e bën ekonominë të ndjeshme ndaj goditjeve sektoriale dhe kufizon diversifikimin afatgjatë. Ndërkohë, industria përpunuese, e cila përfaqëson 15.43 përqind të investimeve, 13 përqind të PBB-së dhe 14 përqind

të qarkullimit, është thelbësore për të adresuar varësinë e disbalancet strukturore të ekonomisë së Kosovës. Kjo mund të arrihet nëse shfrytëzimi i kapaciteteve rritet dhe struktura e investimeve drejtohet drejt elementeve më efektive si makineritë dhe pajisjet, kërkimi dhe zhvillimi dhe trajnimet.

Përqendrimi në këto fusha do të ndihmonte industrinë përpunuese të rrisë produktivitetin dhe të ulë varësinë e lartë të Kosovës nga importet, duke kontribuar në një ekonomi më të qëndrueshme dhe konkurruese.

● **Tabela 17.** Pjesëmarrja e sektorëve në investime, PBB, dhe qarkullim (Përqind)

	Pjesëmarrja në investime	Pjesëmarrja në PB	Pjesëmarrja në qarkullim
Tregtia me shumice dhe pakice; Riparimi i mjeteve motorike dhe motoçikletave	31.23	14	53
Ndërtimtaria	17.13	8	10
Industria përpunuese	15.43	13	14
Furnizimi me rryme, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar	8.23	4	8
Informimi dhe komunikimi	4.96	2	0
Akomodimi dhe shërbimi ushqimor	4.89	2	2
Aktivitetet e patundshmërisë	2.75	7	0
Aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike	2.28	1	2
Transporti dhe magazinimi	1.88	4	3
Industria nxjerrëse	1.65	2	1
Bujqësia; Pylltaria dhe Peshkimi	1.09	7	1
Aktivitetet financiare dhe të sigurimit	0.42	4	4
Aktivitetet e shëndetit të njeriut dhe të punës sociale	0.24	2	1
Arsimi	0.18	3	1

Burimi: Autorët në bazë të të dhënave nga: Anketa e Institutit Riinvest, 2024; ATK; ASK

3.3 Mjedisi Investues

Në shqyrtimet lidhur me vëllimin, dinamikën, strukturën dhe efikasitetin e aktivitetit investues një vëmendje e posaçme duhet t'i kushtohet ndikimeve të mjedisit investues, pra fjalla është për ekosistemin e investimeve. Ky mjedis formësohet nga shumë aktorë ekonomikë e socialë, me këtë rast po veçojmë vetëm tre prej tyre si:

- (1) Rrafshi politiko-institucional duke përfshirë edhe politikat qeveritare ekonomike, qeverisjen makroekonomike dhe sidomos politikat industriale,
- (2) Qasja në financa dhe sektori financiar,
- (3) Informacionet dhe sistemi mbështetës dhe i asistencës teknike për investitorët.

3.3.1 Mjedisi institucional dhe politik

Në rastin e Kosovës, siç u përmend më lart, kemi një aktivitet investues me një thellësi të investimeve në produktin e brendshëm bruto që është më e lartë se në vendet e rajonit. Andaj, mbështetja e investitorëve përmes një mjedisi të favorshëm politikash, ekspertizës dhe shërbimeve të tjera paraqitet me rëndësi të posaçme. Sektori privat krijon më tepër se 2/3 e investimeve dhe është aktori kryesor në gjenerimin e investimeve, andaj duhet të krijohen hapësira bashkëpunimi në nivelin institucional që lehtëson e nxit investimet. Sadoqë cilësia e legjislacionit, niveli relativisht i ulët i tatimeve dhe taksave, si dhe stabiliteti i valutës (Euro) janë faktorë pozitivë që objektivist do të duhej të nxisnin aktivitetin investues, zbatimi i ligjeve, efikasiteti i gjykatave komerciale në mbrojtjen dhe ekzekutimin e obligimeve të kontraktuara, si dhe niveli i korrupsionit, krijojnë barriera problematike për investitorët. Gjithashtu edhe perceptimet mbi jostabilitetin politik veprojnë në drejtimin e reduktimit të pritjeve të bizneseve dhe dekurajojnë investimet e brendshme dhe të jashtme. Perceptimet e udhëheqësve të bizneseve private lidhur me mjedisin investues në Kosovë tregojnë për një neutralitet, përkatësisht pa një mungesë mendimi të formësuar të pjesës dërmuese të repondentëve (43 përqind) dhe një ndarje thuaja e barabartë midis atyre që e konsiderojnë shumë të pafavorshëm ose të pa favorshëm dhe atyre që kanë mendim të kundërt (rreth 28.5 përqind). Besimi në institucionet ka ndikim në politikat dhe mjedisin institucional dhe ka në formësimin e pritjeve të bizneseve dhe

si e tillë mund të jetë nxitës apo frenues për investimet. Në hulumtimin e Riinvest (shtator-tetor 2024) gjithashtu është kërkuar që të vlerësohet besueshmëria për disa nga institucionet që kanë ndikim më të drejtpërdrejtë edhe në incentivat për investime. Rezultatet tregojnë se niveli i besimit në Qeverinë Qendrore dhe qeveritë komunale është i ngjashëm, me përkatësisht 44 dhe 46 përqind nga 100 pikë maksimale. Një nivel të ngjashëm besimi kanë edhe për institucione të tjera si Doganat (46 përqind), ndërsa gjykatat qëndrojnë (49 përqind) dhe ATK (50 përqind) kanë nivel besimi më të mirë. Në anën tjetër, furnizuesit, dhe stafi me të cilin bashkëpunojnë kanë një nivel më të lartë besimi, duke arritur deri në 76.6 përqind.

● **Tabela 18.** Vlerësimet e përgjithshme për mjedisin investues

Vlerësimi	%
Shumë i pafavorshëm	3.2
I pafavorshëm	25.3
Neutral	43.0
I favorshëm	22.7
Shume i favorshëm	5.8
Totali	100.0

Burimi: Anketa e Institutit Riinvest, 2024

Rregullimi i shumë fushave nga institucionet përkatëse (rregullatorët) dhe politikat ekonomike, strategjitë nacionale të zhvillimit dhe strategjitë sektoriale do të duhej të ishin një bazë nisëse e cila krahas sinjaleve të tregut mund ta orientoje dhe nxit aktivitetin investues. Megjithatë këto dokumente të rëndësishme nuk zgjojnë ndonjë interesim as gjatë procesit të hartimit e as gjatë procesit të zbatimit të tyre tek komunitetit i biznesit. Ndër këto dokumente është politika industriale dhe strategja e zhvillimit indus-

trial. Kosova ka aprovuar strategjinë për zhvillim industrial dhe mbështetje të biznesit (Politika industriale) 2023-2030, dokument ky që në aspektin metodologjik ndjek modelin e UNIDO dhe shënon një avancim të politikave, në favor të ofertës vendore dhe në favor të rritjes së prodhimit vendor. Dokumenti përmban me të drejtë politika mbështetëse të karakteri horizontal përgjatë strukturës së prodhimit dhe për krijimin e një mjedisi ku sektorët industrial kanë kushte zhvillimi jodiskriminuese. Dokumenti, megjithatë, veçon dy sektorë (yje): industrinë e drurit dhe atë të plastikës dhe gomës, të cilat kanë shënuar rezultate të mira, veçanërisht në eksport. Pa mohuar rëndësinë e këtyre sektorëve, dhe duke u mbështetur në orientimin për të mbështetur sektorët që përfshijnë inputet vendore në zinxhirin vleror (si lëndët e para dhe komponentët e tjera), sugjerojmë që të përfshihen patjetër edhe dy sektorë të tjerë: industria e prodhimit dhe përpunimit të ushqimit (duke përfshirë prodhimin dhe përpunimin e qumështit, mishit, frutave dhe perimeve) dhe sektori i Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit-TIK (ICT). Do të ishte me interes të realizohej një studim mbi performancën e sektorëve të prodhimit dhe shërbimeve me orientim eksportues, duke u fokusuar në aftësinë e tyre konkurruese, zinxhirin vleror dhe potencialet zhvillimore. Një analizë e tillë do të ndihmonte në formulimin e politikave industriale më efektive në Kosovë, duke siguruar një raport më të mirë mes kostove dhe përfitimeve nga ndërhyrjet qeveritare.

Me rëndësi vendimtare është të fuqizohet dhe promovohet ngritja e vetëdijes për domosdoshmërinë e forcimit të kërkimeve dhe inovacioneve dhe krijimit të kushteve më të mira për investime në kërkime dhe zhvillim e inovacione nga bizneset. Për këtë MINT duhej të nxisë bashkëpunimin me asociacionet e biznesit dhe bizneset, që tanimë kanë kaluar në një stad më cilësor zhvillimi, për të stimuluar zhvillimin e aktiviteteve kërkimore në sektorët e prodhimit dhe bashkëpunimin e tyre institucionet akademike kërkimore në vend e më gjerë.

Qëllimi primar i politikave industriale është diversifikimi i strukturës ekonomike. Në mungesë të kësaj ne kemi parë një konservim të një strukture të pavolitshme të ekonomisë për më shumë se dy dekada (Tabela 4). E kjo kërkon një portfolio të instrumenteve që sajojnë një kompletaritet për të arritur efekte të synuara. Kështu për Kosovën janë të rëndësishme projektet që sigurojnë rritje të eksportit, zëvendësim të importit dhe njëkohësisht që sigurojnë punësim. Përvojat tregojnë se shumica e arritjeve lidhur me diversifikimin e prodhimit dhe shërbimeve janë rezultat i përpjekjeve të përqendruara të qeverisë, brenda një partneriteti e bashkëpunimit publiko – privat. Intervenimet më të mira të këtyre politikave do të ishin ato që përqendrohen në aktivitete, projekte jo në sektor, dhe ato që kanë efekte ndërsektoriale në një shtrirje (siprover) më të gjerë³⁶. Një formë fleksibile e bashkëpunimit strategjik midis sektorit privat dhe publik që përfshin një lider ship të përkushtuar politik. Ministrat dhe udhëheqësit më të lartë në qeveri. Për shembull, Kryeministri bazuar në disa përvoja të suksesshme me lider ship koordinimi, me prezencë të ministrave kyç, do duhej ta udhëhiqte këtë proces që ka një mekanizëm efektiv të monitorimit të burokratëve³⁷. Trupa publiko-private (me përfaqësues të bizneseve, asociacioneve) duhet të sigurojnë bashkërenditje të agjencive qeveritare, dhe avokojnë për ndryshime, zvogëlim të shpenzimeve të transak sionit dhe mbështetje financiare, mekanizmat e monitorimit, transparencës dhe përgjegjësisë. Agjencitë zbatuese duhet të kenë kompetenca për të monitoruar rreptë rezultatet dhe krahasuar ato me objektiva. Efektet lidhur me subvencionet që ndërmerr qeveria e Kosovës tash e disa vite flasin më se miri për këtë nevojë. Tani ato arrijnë qindra milion Euro, por nuk ka monitorim dhe auditim të performaces, nuk ka llogaridhënie për efektet dhe vlerësim të rezultateve të arritura pas zbatimit të projekteve. Investimet publike për laboratoriumet publike dhe kërkime dhe zhvillim, infrastruktura fizike, infrastruktura sanitare, fitopatologjia, edukimi profesional, trajnimi teknik dhe mjedisi adekuat biznesor duke përfshirë politikat adekuate fiskale dhe tregtare do të përbënin një kombinim të duhur. Në fakt këto edhe do të mund të quheshin një bashkësi masash të integruara dhe komplementare për diversifikim të portfolios së ofertës dhe njëkohësisht për rritje të aftësisë konkurrues të produkteve dhe shërbimeve të Kosovës për eksport dhe për tregun vendor.

36 Shih lidhur me këtë edhe D. Roderik (2004) dhe J. Stiglitz (2016)

37 Një shembull efektiv të këtij koordinimi dhe bashkërenditje paraqet Turqia me institutin IGEME që është i vendosur nën përkujdesjen e Kryeministrit me përqendrim në rritjen e investimeve dhe eksporteve.

3.3.2 Qasja në financa

Mjedisi investues i Kosovës karakterizohet me produkte tradicionale financiare dhe zhvillim të ulët të instrumenteve financiare për mbështetjen e investimeve në biznese fillestare, si dhe për financimin e programeve investuese. Kjo shihet qartësisht nga Tabela 19, e cila prezanton një pasqyrë të përgjigjeve të respondentëve në anketë lidhur me kapitalin fillestar për nisjen e biznesit. Shihet se mbështetja dominante ka burimet tek familja (kapitali vetanak, financimi nga ana e familjarëve dhe miqve në vend dhe diasporë) me

84 përqind. Roli i bankave ende mbetet i vogël, me rreth 14 përqind, ndërkaq roli i granteve dhe partnerëve në diasporë është shumë marginal, me 0.5 përqind dhe 0.1 përqind.

Kjo situatë e financimit të bizneseve nga rrjeti familjar mbetet edhe më dominante për financimin e investimeve për zhvillimin e mëtejshëm (shih Tabela 20). Ky rrjet formëson mbi 86 përqind të burimeve të financimit të investimeve. Bankat sigurojnë afër 10 përqind të burimeve financiare për investime, kurse partneritetet nga diaspora janë afër 4 përqind.

● **Tabela 19.** Sigurimi i kapitalit fillestar

Indikatori	%
Kapitalit vetanak	64.6
Borxhi/ kreditë nga bankat	14.2
Financimit nga ana e familjes apo miqve që jetojnë në Kosovë	11.5
Financimit nga ana e familjareve apo miqve që jetojnë në diasporë	7.7
Granteve nga organizata donatore	1.4
Pjesëmarrjes nga partnereve/investitorëve nga diaspora	0.5
Tjetër	0.1

Burimi: Anketa e Institutit Riinvest, 2024

● **Tabela 20.** Burimet e financimit të investimeve

Indikator	%
Fondet vetanake apo riinvestim i fitimit për investimet e evidentuara në 2023?	72.0
Kredi nga bankat për investimet e evidentuara në 2023?	9.7
Grante Qeveritare për investimet e evidentuara në 2023?	1.2
Financimi nga familjaret ose miqtë në Kosove për investimet e evidentuara në 2023?	7.8
Financimi nga familjaret ose miqtë nga diaspora për investimet e evidentuara në 2023?	5.4
Financimi nga Investime nga diaspora për investimet e evidentuara në 2023?	3.9
Financimi nga ndonjë opion tjetër për investimet e evidentuara në 2023?	0.0

Burimi: Anketa e Institutit Riinvest, 2024


Ky hulumtim i Institutit Riinvest dëshmon se bankat ende nuk janë një opion i preferuar për financimin e investimeve. Vetëm rreth 18 përqind e bizneseve kanë marrë kredi në vitet 2023-2024. Siç shihet nga grafi afër 60 përqind të krdirrëmësve i konsiderojnë kushtet e pavolitshme të financimit nga bankat për investimeve, kur norma mesatare e interesit nga respondentet del të jetë 7.9 përqind, ndërsa afati i kthimit 4.6 vite, gjithsesi kushte jo të volitshme për financimin e investimeve.

Kjo tregon gjithsesi se investitorët nga sektori privat nuk i konsiderojnë bankat adresën e parë në aktivitetin e tyre investues. Prandaj, opsioni kryesor mbetet familja dhe rrjeti

familjar në vend, dhe në një nivel më të ulët edhe në diasporë. Banka Qendrore, asociacioni i bankave dhe vetë bankat duhet të shqyrtojnë këtë situatë dhe të krijojnë kushte më të volitshme për investime, sidomos në kushtet kur instrumentet e tjera të financimit nga tregu financiar nuk janë të zhvilluara. Gjithashtu, Qeveria duhet të shqyrtojë se si ta kompletojë kornizën ligjore për zhvillimin e shumë elementeve të financimit të investimeve (faktoringu, lizingu, fondet investuese). Një nga mundësitë që duhet shqyrtuar është edhe bashkëpunimi i qeverisë dhe institucioneve financiare ndërkombëtare për krijimin e linjave të posaçme të kredive investive për sektorët eksportues dhe për produktet dhe shërbimet me vlerë të lartë shtuese.

● Figura 11. Kushtet e kredisë

Kushtet e kredisë



Burimi: Anketa e Institutit Riinvest, 2024

3.3.3 Shërbimet mbështetëse të bizneseve dhe asistenca teknike

Shërbimet mbështetëse të bizneseve përfshijnë një varg produktesh të cilat e lehtësojnë punën e bizneseve dhe i ndihmojnë ata që në operacionet e tyre të jenë efektivë dhe efikasë, si dhe të arrijnë një rritje të qëndrueshme. Këto shërbime zakonisht përfshijnë aspekte të ndryshme të planifikimit dhe përcaktimit të strategjisë së bizneseve, shërbime

financiare dhe menaxhim financash, marketing, ndërtimi i brendit, marketing digjital dhe komunikimi në web, zhvillimi i produkteve në web, shërbimet legale dhe juridike, përkujdesja ndaj konsumatorëve e të ngjashme. Ato ofrojnë edhe programe edukimi dhe trajnimi të stafit. Një rëndësi të posaçme këto shërbime padyshim e kanë sidomos kur është fjala për investimet, planifikimin, vlerësimin e efekteve dhe realizimin e tyre.

Përkundër faktit se kemi një zhvillim gradual të këtyre shërbimeve që ofrohen për nevoja të bizneseve, duket se kur është fjala për marrjen e vendimeve rreth investimeve, përdorimi i tyre nuk është në nivelin e domosdoshëm. Tabela 21 përmban një pasqyrë të ekspertizës që bizneset e shfrytëzojnë gjatë procesit investiv. Bazuar në përgjigjet e respondentëve, bizneset në shumicë mbështeten në ekspertizën e brendshme (75 përqind) dhe vetëm rreth 16 përqind e bizneseve praktikojnë të kontraktojnë shërbime nga organizatat konsulente apo institute kërkimore për hartimin e studimeve të fizibilitetit dhe planeve të bizneseve. Nga 463 biznese të anketuara, vetëm 18 (4 përqind) kanë marrë shërbime për

konsulencë dhe mbështetje nga donatorët ose organizatat ndërkombëtare dhe 25 ose diçka më shumë se 5 përqind kanë shfrytëzuar ekspertizë nga Shoqatat afariste. Asociacionet e bizneseve duhet ta zhvillojnë më shumë pikërisht këtë funksion.

Duke marrë parasysh kompleksitetin e procesit investiv dhe pasigurinë që e përcjell atë, asociacionet e bizneseve dhe aktorët e tjerë duhet t'i zhvillojnë aktivitete për të rritur vetëdijen mbi nevojën që të ngritet niveli i cilësisë së ekspertizës për planifikimin, vlerësimin dhe zbatimin e projekteve lidhur me investimet.

● **Tabela 21.** Shërbimet mbështetëse dhe asistenca teknike për përgatitjen dhe vlerësimin e investimeve

Indikatori	%
Ekspertizën e brendshme (kemi analizuar vete situatën)	74.9
Keni angazhuar ekspertë apo organizatë konsulente, apo institute kërkimore për hartimin e studimit të fizibilitetit dhe planit të biznesit	15.8
Na ka ofruar ekspertize donatori, organizata ndërkombëtare	3.9
Na kanë ofruar ekspertize shoqatat afariste	5.4
Total	100.0

Burimi: Anketa e Institutit Riinvest, 2024

REFERENCAT

Agjencia e Statistikave të Kosovës (2024). Repertori Statistikor mbi Ndërmarrjet Ekonomike në Kosovë - Shtator 2024. Linku: <https://askapi.rks-gov.net/Custom/4e09a68b-c7c5-4a10-b474-19d2e442050c.pdf>

Agjencia e Statistikave të Kosovës. (2023). Statistikat e Hotelerisë. Të qasshme në: <https://ask.rks-gov.net/Themes/Tourism>

ASHAK (2023). The Position of Kosovo's Economy in Global Competitiveness.

Autoriteti i Aviacionit Civil. (2023). Statistikat e udhëtarëve, fluturimeve dhe kargos në ANP «Adem Jashari». E qasshme në: <https://caa.rks-gov.net/wp-content/uploads/2024/01/Statistikat-e-perpunuara-2023-15012024-1.pdf>

Banka Botërore (2024) Përditësimi ekonomik për Evropën dhe Azinë Qendrore, Pranverë 2024

Banka Botërore (2024). Balkans Regular Economic Report, Retaining Growth Momentum NO.26 Fall 2024

Banka Botërore (2024). Invigorating Growth. Western Balkans Regular Economic Report No.25. E qasshme në: <https://www.worldbank.org/en/region/eca/publication/western-balkans-regular-economic-report>

Banka Botërore (2024). Raporti i rregullt ekonomik i Ballkanit Nr.26, vjeshtë 2024.

Banka Qendrore e Kosovës. (2024). Raporti vjetor 2023. E qasshme në: https://bqk-kos.org/wp-content/uploads/2024/06/BQK_RV_2023.pdf

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) (2024). Vlerësimi Tremujor i Ekonomisë, Nr. 46, TM I/2024. Available at: https://bqk-kos.org/wp-content/uploads/2024/08/BQK_VTE_TM12024.pdf

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Buletini Mujor Statistikor, nr. 276, Prishtinë 2024.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) (2024). Raporti Mujor i Sistemit Financiar, shtator 2023 - shtator 2024, Prishtinë 2024.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Seritë Kohore, shtator 2024, Prishtinë 2024.

European Commission (2023). Kosovo* 2023 Report. Available at: https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/kosovo-report-2023_en

European Commission (2024). Kosovo* 2024 Report. Available at: https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/kosovo-report-2024_en

Fondi Kosovar për Garnci Kreditore (FKGK) (2023). Annual Report 2023. Available at: <https://fondikgk.org/wp-content/uploads/2024/08/ANNUAL-REPORT-2023.pdf>

Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN). (2024) World Economic Outlook, Korrik.

Fondi Monetar Ndërkombëtar. (2024). Republic of Kosovo: 2024 Article IV consultation—Press release; staff report; and statement by the Executive Director for the Republic of Kosovo (Country Report No. 24/147). E qasshme në: <https://www.imf.org/en/Publications/CR/Issues/2024/06/04/Republic-of-Kosovo-Second-Reviews-Under-the-Stand-By-Arrangement-and-the-Arrangement-Under-549864>

Government of Kosovo (GoK) (2024). Employment Strategy – Kosovo 2024-2028. Available at: <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2024/07/Employment-Strategy-2024-2028.pdf>

Government of Kosovo- GoK (2022). Economic Reform Programme (ERP). Available at: <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/08/Economic-Reform-Programme-2022-24.pdf>.

Instituti Riinvest (2023). A NEW MODEL FOR SUSTAINABLE ECONOMIC GROWTH labour market dynamics: current and future challenges. Available at: https://www.riinvestinstitute.org/uploads/files/2023/November/13/19_-_Forumi_Ekonoik_Vjetor_-_ENG031699882718.pdf

Instituti Riinvest (2024). Një terapi e munguar për financimin e shëndetësisë. Prishtinë.

Kosovo Democratic Institute-KDI (2024). Reforma në Drejtësi: Arritjet, Sfidat dhe Rruga Përpara. Available at: https://kdi-kosova.org/ë_p-content/uploads/2024/06/Progresi-i-Reformes-ne-Drejtësi_final.pdf

M. Mustafa & A. Hashani (2024). Bashkëpunimi ekonomik rajonal , mundësitë për Shqipërinë dhe Kosovën ASHAK, 2024

McKinsey & Company (2024). Strategjia dhe Praktika e Financave Korporative, Parashikimi i Kushteve Ekonomike. McKinsey & Company, Shtator.

MFPT (2023). Buletini vjetor 2023 për borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore. <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/739116D9-9225-4EEE-A131-74B48859BE49.pdf>

MFPT (2024). Projektligji mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025

MFPT (2024). Seritë Fiskale Mujore: <https://mfpt.rks-gov.net/Thesari/Page/973>

MFPT (2024). Seritë Fiskale Mujore: <https://mfpt.rks-gov.net/Thesari/Page/973>

Ministry of Education, Science, Technology and Innovation (MESTI) (2022). Education Strategy 2022-2026. Available at: <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2023/01/Strategjia-e-Arsimit-2022-2026-Eng-Web.pdf>

OECD (2024). *Western Balkans Competitiveness Outlook 2024: Kosovo*, Competitiveness and Private Sector Development, OECD Publishing, Paris, <https://doi.org/10.1787/ff74ae0e-en>.

RCC Balkan Business Barometer 2023. Available at: <https://www.rcc.int/balkanbarometer/results/1/business>

STIKK. (2022). Kosovo IT Barometer 2021 – 2022. E qasshme në: https://stikk.org/wp-content/uploads/2023/07/IT_Barometer_2021-2022_STIKK.pdf

Wiiw. (2024). The Crisis is Over, but its Scarring Effects are Hindering Recovery. E qasshme në: <https://wiiw.ac.at/the-crisis-is-over-but-its-scarring-effects-are-hindering-recovery-p-6842.html>

World Bank (2019). World Bank Enterprise Survey. Available at: <https://www.enterprisesurveys.org/content/dam/enterprisesurveys/documents/country/Kosovo-2019.pdf>

World Bank (2024a). Western Balkans Regular Economic Report No.25 | Spring 2024.

World Bank, (2024b). Western Balkans: Regular Economic Report No.26 | Fall 2024

ZKA (2023) Raporti vjetor i Auditmit https://zka-rks.org/cms/ReportFiles/2024_24e084aa-f75c-4c23-9828-fd8dea53fe6b.pdf

Zyra e Kryeministrit (ZKM) (2024). Raporti i zbatimit të Programit për Parandalimin dhe Zvogëlimin e Barrës Administrative 2022-2027 dhe Planit të veprimit 2022-2024. Linku: <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2024/01/RAPORTI-I-ZBATIMIT-TE-PROGRAMIT-PER-PARANDALIMIN-DHE-ZVOGELIMIN-E-BARRES-1.pdf#page=33.04>

Zyra e Kryeministrit- ZKM (2022). Programi për Parandalimin e Barrës Administrative <https://kryeministri.rks-gov.net/ëp-content/uploads/2022/09/ZPS-shtator2022-PPZBA-2022-2027-dhe-PV-2022-2027-Shtojca-1-6-FINAL-ALB.pdf>

